

B a n k a e S h q i p ë r i s ë

2 0 0 0 4

BULETINI
I BILANCIT TË PAGESAVE

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558

www.bankofalbania.org

Për komentet dhe sugjerimet tuaja na shkruani në:
Sektori i Publikimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun.
E-mail: public@bankofalbania.org

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 1000 kopje

P Ë R M B A J T J A

I.	<i>HYRJE</i>	7
II.	<i>Një vështrim mbi Bilancin Shqiptar të Pagesave gjatë viteve 2000</i>	9
III.	<i>Zhvillime të përgjithshme në Bilancin e Pagesave gjatë vitit 2004</i>	12
III.1.	<i>Llogaria korente.</i>	13
III.1.1	<i>Tregtia e jashtme.</i>	14
III.1.2	<i>Shërbimet.</i>	20
III.1.3	<i>Të ardhurat.</i>	24
III.1.4	<i>Transferrat korente.</i>	25
III.2.	<i>Llogaria kapitale dhe financiare.</i>	25
III.2.1.	<i>Natyra dhe përbërja e flukseve shqiptare të kapitalit.</i>	26
III.3.	<i>Rezervat valutore.</i>	28
IV.	<i>Borxhi i jashtëm</i>	29
	ANEKS	31
1.	<i>Tregtia me vendet e rajonit në kuadër të marrëveshjeve të tregtisë së lirë</i>	31
	<i>Tregtia me Maqedoninë.</i>	32
	<i>Tregtia me Kroacinë.</i>	33
	<i>Tregtia me Bullgarinë.</i>	33
	<i>Tregtia me Kosovën.</i>	33
	<i>Tregtia me Rumaninë.</i>	33
	<i>Tregtia me Serbinë dhe Malin e Zi.</i>	34
	<i>Tregtia me Bosnje-Hercegovinën dhe Moldavinë.</i>	34
2.	<i>Analiza e rezultateve të vërtimit të turizmit për vitin 2004</i>	34
2.1.	<i>Metodologjia e vërtimit.</i>	34
	<i>Problematika.</i>	35
2.2.	<i>Rezultatet e vërtimit për vitin 2004.</i>	36
	<i>Arsyet e udhëtimit.</i>	37
	<i>Aneks - Fjalor</i>	39
	<i>Referenca</i>	40

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

III. Zhvillime të përgjithshme në Bilancin e Pagesave gjatë vitit 2004

Tabelë 1.	<i>Treguesit kryesorë të bilancit të pagesave në raport ndaj PBB-së.</i>	13
Tabelë 2.	<i>Eksporti sipas klasifikimit SITC (në milionë usd).</i>	15
Tabelë 3.	<i>Importi sipas klasifikimit SITC (në milionë usd).</i>	17
Tabelë 4.	<i>Shpërndarja e eksporteve sipas partnerëve tregtarë në vite, ndryshimi vjetor për vitin 2004.</i>	19
Tabelë 5.	<i>Shpërndarja e importeve sipas partnerëve tregtarë në vite, ndryshimi vjetor për vitin 2004.</i>	20

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

II. Një vështrim mbi Bilancin Shqiptar të Pagesave gjatë viteve 2000

Grafik 1. Ecuria e treguesve kryesorë.	9
Grafik 2. Investime, kursime dhe deficit korent në përqindje ndaj PBB-së.	10
Grafik 3. Deficiti korent në përqindje ndaj PBB-së.	12

III. Zhvillime të përgjithshme në Bilancin e Pagesave gjatë vitit 2004

Grafik 4. Shpërndarja e hyrjeve (të ardhurat) dhe e daljeve (shpenzimet) në llogarinë korente (në përqindje).	13
Grafik 5. Bilanci tregtar (në milionë usd).	14
Grafik 6. Ritmet e rritjes së eksporteve dhe importeve.	15
Grafik 8. Eksporti nga prodhimi i brendshëm sipas grupmallrave (në milionë usd).	16
Grafik 7. Eksporti nga prodhimi i brendshëm (në milionë usd).	16
Grafik 9. Kontributi i tregtisë nga përpunimi aktiv në vëllimin e përgjithshëm tregtar (importe+eksporte në milionë usd).	18
Grafik 10. Paraqitja e strukturës së aktivitetit tregtar nga përpunimi aktiv.	18
Grafik 11. Bilanci i shërbimeve - fluksi neto në milionë usd.	21
Grafik 12. Bilanci i të ardhurave (në milionë usd).	24
Grafik 13. Ecuria e dërgesave të emigrantëve (në milionë usd).	25
Grafik 14. Llogaria financiare në vite - fluksi neto (në milionë usd).	26
Grafik 15. Financimi i deficitit korent nëpërmjet investimeve të huaja.	27
Grafik 16. Rezerva valutore në muaj importe.	28

IV. Borxhi i jashtëm

Grafik 17. Struktura e borxhit të jashtëm sipas sektorëve debitorë.	30
Grafik 18. Struktura e borxhit të jashtëm sipas monedhave.	30

ANEKS

1. Tregtia me vendet e rajonit në kuadër të marrëveshjeve të tregtisë së lirë

Grafik 1. Eksportet shqiptare me vendet e rajonit (në milionë usd).	31
Grafik 2. Importet me vendet e rajonit (në milionë usd).	32

2. Analiza e rezultateve të vrojtimit të turizmit për vitin 2004

Grafik 1. Hyrjet e shtetasve të huaj dhe emigrantë sipas shteteve.	36
Grafik 2. Ditëqëndrimi mesatar për turistët shqiptarë dhe të huaj sipas qëllimit të udhëtimit për vitet 2002-2004 (sipas tremujorëve).	37
Grafik 3. Shpenzimet mesatare ditore për turistët shqiptarë dhe të huaj sipas qëllimit të udhëtimit për vitet 2002-2004 (sipas tremujorëve).	38
Grafik 4. Struktura e shpenzimeve të emigrantëve dhe udhëtarëve të huaj në Shqipëri.	38

HYRJE

Bilanci i pagesave prezanton sintetikisht marrëdhëniet ekonomike dhe financiare të Shqipërisë me botën e jashtme – të transaksioneve korente dhe financiare.

Pozicioni neto i llogarisë korente përfaqëson një tregues të rëndësishëm dhe delikat në vlerësimin e ecurisë së ekonomisë shqiptare gjatë tranzicionit¹. Nga njëra anë, një deficit korent reflekton fuqinë rritëse të ekonomisë, i parë si matës i burimeve të hyra në vend për financimin e kërkesës për investime, që tejkalon kursimin kombëtar. Nga ana tjetër, një deficit korent reflekton një mosbalancim të rrezikshëm mes kursimit kombëtar e investimeve të brendshme, si dhe akumulimin e borxhit, për të cilin ekonomia nuk ka fuqi paguese. Mes këtyre këndvështrimeve është e vështirë të dallosh deficitet korente që janë pasojë e rritjes ekonomike, duke nxitur hyrje të kapitaleve, dhe deficitet korente që rezultojnë në akumulimin e pandërprerë të borxhit. Në një pamje të parë, deficitet reflekton suksesin në ndryshime strukturore ekonomike, të cilat çojnë në flukse hyrëse të kapitalit, investime dhe rritje ekonomike.

Në një tjetër aspekt, deficitet korent reflekton procesin e tranzicionit, i cili jo gjithmonë ka qenë i mirëadministruar. Ekonomia shqiptare në tranzicion ka qenë subjekt i disa zhvillimeve të paparashikuara, që kanë çuar në rritje të përkohshme të deficitit korent (1997), si dhe i është nënshtruar ndryshimeve të rëndësishme strukturore, të cilat mund të kërkojnë mosbalancime korente për periudha afatgjata.

Deficite të larta korente duhet detyrimisht të financohen nga një rritje e detyrimeve kundrejt botës ose një pakësim i mjeteve të huaja financiare. Në këtë kontekst, pozicioni i llogarisë kapitale e financiare është një tregues po aq i rëndësishëm sa edhe bilanci korent. Përbërja dhe natyra e detyrimeve dhe mjeteve financiare si dhe lëvizjet e tyre janë, gjithashtu, një tregues i rëndësishëm i zhvillimeve të pritshme ekonomike.

Llogaritë kombëtare, të cilat përdoren në vlerësimin e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), ofrojnë një strukturë të dobishme në analizën e lidhjes ndërmjet bilancit korent dhe flukseve neto të kapitalit, si dhe në marrëdhënien e bilancit të pagesave me kursimet dhe investimet e brendshme. Boksi më poshtë ofron më në detaje prejardhjen e këtyre marrëdhënieve.

Boks 1. Kursime, investime dhe bilanc korent. Prezantimi i bilancit korent në flukse kapitali.

Duke përdorur llogaritë kombëtare mund të tregojmë se kur kemi ekuivalencë mes bilancit korent dhe flukseve hyrëse të kapitalit.

Në të ardhurat e përgjithshme kombëtare, prodhimi kombëtar i përgjithshëm (GNP) trajtohet si shuma e të ardhurave të rrjedhura nga prodhimi i mallrave dhe i shërbimeve nën kategoritë: konsum privat (C), investime private (I_p), mallra dhe shërbime qeveritare (G) dhe eksporte (X). Importet (M) trajtohen si një zë negativ për të mënjeluar dublimin në llogaritjen e mallrave për konsum apo investime të blera në tregun e brendshëm, por të prodhuara jashtë.

$$\begin{aligned} & \text{Kështu,} \\ & \text{GNP} = C + I_p + G + (X - M), \\ & \text{Ku, } X - M \text{ paraqet eksportin neto plus faktorin neto të të ardhurës*} \end{aligned}$$

Një ekuacion i dytë i llogarive të të ardhurave kombëtare bazohet në specifikimin që çdo e ardhur e individëve ka katër mundësi përdorimi: konsum (C), kursim (S_p – kursim privat), taksa të paguara (T) apo të transferuara jashtë (T_r).

Duke qenë se GNP është shuma e të ardhurave të përfituara nga tërësia e individëve në një ekonomi, kemi:

$$\text{GNP} = C + S_p + T + T_r$$

Duke barazuar dy shprehjet e GNP të zhvilluara më sipër, përftojmë ekuacionin e mëposhtëm:

$$X - M - T_r = (S_p - I_p) + (T - G),$$

ku $X - M - T_r$ përfaqëson llogarinë korente.

Në këtë kuptim, llogaria korente është e barabartë me bilancin e kursim investimeve private dhe bilancin fiskal të qeverisë. Kështu, del qartë se një deficit buxhetor duhet patjetër të shoqërohet ose nga një bilanc pozitiv kursime investimesh ose nga një deficit korent. Në këtë kuadër, deficitet buxhetore të vazhdueshme do të reflektohen në përkeqësimin e vazhdueshëm të bilancit të llogarisë korente.

Pra, politikat fiskale të ndjekura nga qeveria mund të ndikojnë në përkeqësimin apo anasjelltas, të pozicionit të jashtëm të vendit. Për të shpjeguar lidhjen mes bilancit të llogarisë korente dhe flukseve të huaja neto ndjekim logjikën e mëposhtme: Një mjet monetar i kursyer mund të klasifikohet sipas tipeve të aktiveve që ai ble. Në veçanti, kursimet mund të përdoren për blerjen e kapitalit fizik të brendshëm, borxhit të qeverisë apo të mjeteve të huaja (FA) të llojeve të ndryshme. Duke patur parasysh që, borxhi i qeverisë është deficit buxhetor (G-T) kemi,

$$S_p = I_p + (G - T) + FA$$

$$\begin{aligned} & \text{nga ku,} \\ & \text{FA} = (S_p - I_p) + (T - G) \quad \text{pra} \quad \text{FA} = X - M \end{aligned}$$

* Faktori neto i të ardhurës përfshin fitimet nga mjetet e brendshme dhe ato të huaja.

II. NJË VËSHTRIM MBI BILANCIN SHQIPTAR TË PAGESAVE GJATË VITEVE 2000


Sektori i jashtëm i ekonomisë, në këtë dekatë të dytë të tranzicionit shqiptar, paraqitet me një bilanc negativ në llogarinë korente, shkaktuar nga një deficit i lartë tregtar. Flukset hyrëse në kapitale kanë qenë përgjithësisht të mjaftueshme për kompensimin e deficitit korent, duke mundësuar një bilanc të përgjithshëm pozitiv (dukshëm në rritje gjatë dy viteve të fundit).

Treguesi relativ i deficitit korent (përfshijtur transfertat zyrtare) ndaj PBB-së, ka variuar nga 7 për qind në vitin 2000 në 5.7 për qind vlerësuar për vitin 2004, duke arritur nivelin maksimal në vitin 2002 (rreth 10 për qind). Përgjithësisht, pranohet se një nivel mbi 5 për qind i këtij treguesi duhet të tërheqë vëmendjen për përbalueshmërinë e tij. Vlerësimi i qëndrueshmërisë së deficitit korent lidhet së pari me analizën e burimeve të tij si dhe me atë të flukseve kapitale që mundësojnë financimin e deficitit korent në perioda afatshkurtra dhe afatgjata.


Nëse i referohemi deficitit korent si diferencë e kursime-investime, vërejmë se vitet 2000 janë karakterizuar nga rritje e nivelit relativ të kursimeve të brendshme dhe investimeve ndaj PBB-së. Kursimet përfaqësohen kryesisht nga ato të sektorit privat. Ndërkohë që, një zhvillim pozitiv është rritja e kursimeve publike (pakësimi i deficitit fiskal). Nga një nivel negativ prej rreth -9 për qind e PBB-së në vitin 1996, kursimet qeveritare² shënojnë terma pozitivë gjatë vitit 2004 duke u vlerësuar në 0.3 për qind e PBB-së.

Gjithashtu, investimet u rritën nga 15.5 për qind e PBB-së në vitin 1996, në 25.4 për qind në vitin 2004. Brenda strukturës së investimeve, investimet private janë rritur ndjeshëm duke përfaqësuar, në masën më të madhe, investimet në vend (për vitin 2004 ato vlerësohen në 20.2 për qind të PBB-së nga 11 për qind në vitin 1996), ndërkohë që investimet publike vlerësohen në nivele të ulëta (nga 4.5 për qind e PBB-së në 1996 në 5.2 për qind në vitin 2004). Në përgjithësi, arrihet përfundimi se gjatë kësaj periudhe burim i deficitit korent ka qenë rritja e investimeve private.

Grafik 1. Ecuria e treguesve kryesorë të Bilancit të Pagesave (në milionë usd).



Burimi: Banka e Shqipërisë.



Ritmet e larta të investimeve kanë induktuar rritje të importeve dhe për rrjedhim, deficite të larta tregtare. Deficiti tregtar ka përbërë një tipar të përhershëm të zhvillimeve të tregtisë së jashtme, duke diktuar nivelet e larta të deficitit të llogarisë korente. Treguesi relativ i importeve ndaj PBB-së, mesatarisht përgjatë viteve 2000 vlerësohet në rreth 30.9 për qind. Në mëse 58 për qind të totalit importi prezantohet në mallra kapitalë dhe mallra të ndërmjetëm (shih boks 2.), ndërkohë që kërkesa e brendshme për mallra konsumi ka mbetur e lartë. Megjithatë, investimet private në kapitalin prodhues janë shoqëruar me rritje të kapaciteteve prodhuese për eksporte, një tipar i dallueshëm i ekonomisë së jashtme mbetet niveli i ulët i eksporteve. Përgjatë viteve 2000 ato kanë përbërë mesatarisht rreth 7.5 për qind të PBB-së, duke përballuar financimin

e vetëm rreth 24 për qind të vëllimit të importeve të ekonomisë.

Deficitet e larta tregtare, në vite, janë financuar jo vetëm nga flukset hyrëse në kapitale, por mundësi të konsiderueshme financimi janë vërejtur brenda vetë llogarisë korente, përmes dërgesave nga emigrantët. Gjatë periudhës 2000 – 2004, fluksi neto i transfertave korente arriti në rreth 3.7 miliardë usd, nga të cilat vlerësohet se mëse 97 për qind janë kontribut i emigracionit shqiptar. Dërgesat për vitin 2004 vlerësohen në 1028 milionë usd ose në rreth 13.5 për qind të PBB-së.

Deficitet korente janë financuar me flukse hyrëse të kapitalit të huaj në formën e transfertave kapitale (kryesisht grante qeveritare), si dhe me flukse financiare në formën e investime të huaja direkte dhe të huamarrjes me jashtë.


Më shumë se gjysma e flukseve të kapitalit vërehet të ketë qenë kontribut i investimeve të huaja direkte. Këto flukse janë rritur ndjeshëm krahasimisht me nivelin e tyre gjatë viteve '99 si rezultati i privatizimit, duke përfaqësuar mesatarisht për periudhën 2000-2004 rreth 4 për qind të PBB-së. Megjithatë, situata përgjithësisht problematike në Ballkan, si dhe mungesa e një ambienti të përshtatshëm dhe atraktiv për investime të huaja direkte brenda vendit, rezultojnë në flukse modeste të këtij treguesi për vendin tonë. I vënë në raport me totalin e hyrjeve në formën e transfertave korente dhe të hyrave në formën e kredive dhe të investimeve të huaja, totali i investimeve direkte të huaja të realizuara përbën një shifër shumë të ulët.

Një tipar dallues i zhvillimeve financiare të Shqipërisë me jashtë, gjatë këtyre viteve të fundit, është akumulimi i borxhit të jashtëm duke rritur nivelin e detyrimeve për ripagime dhe pagesa interesi. Shqipëria, deri në fund të vitit 2004, ka grumbulluar një borxh të jashtëm zyrtar prej 1.4 miliardë dollarësh. Ky nivel borxhi, si në terma absolutë ashtu edhe i vlerësuar ndaj PBB-së (mesatarisht për periudhën 2000-2004 vlerësohet në rreth 19 për

qind) apo si stok detyrimesh për frymë, paraqitet relativisht i ulët krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Shtesa vjetore e stokut të borxhit të jashtëm gjatë viteve të fundit ka ardhur në rritje, me një mesatare vjetore për vitet 2002-2004 në rreth 230 milionë usd. Ndërkohë, një zhvillim i viteve të fundit është pjesëmarrja e sektorit privat në aktivitetin huamarrës me jashtë. Për vitin 2004, huamarrja private arriti në rreth 34 për qind të totalit. Shërbimi i borxhit të jashtëm vlerësohet në nivele modeste, duke arritur në rreth 4.3 për qind të totalit të eksporteve, gjatë vitit 2004 ose shumë poshtë nivelit prej 25 për qind, të konsideruar përgjithësisht si nivel kritik. Përgjithësisht, arrihet përfundimi se Shqipëria nuk është në prag të ballafaqimit me aftësi paguese të borxhit të jashtëm.

Megjithë zhvillimet pozitive që kanë karakterizuar tregtinë në mallra dhe shërbime gjatë viteve të fundit, shkalla e hapjes së ekonomisë³ mbetet në nivele mjaft të ulëta (64 për qind mesatarisht për periudhën 2000-2004) në raport me ekonomitë e rajonit. Shënjestra vihet në nivelin e ulët të eksportit të mallrave, i cili bën që tregtia (efekti neto) të mos aktivizohet plotësisht si një burim i rritjes së ekonomisë. Në këtë kontekst, thellimi i shkallës së hapjes përbën një ndër sfidat e rëndësishme të ekonomisë shqiptare për të ardhmen.

III. ZHVILLIME TË PËRGJITHSHME NË BILANCIN E PAGESAVE GJATË VITIT 2004



Situata e favorshme ekonomike në vend është reflektuar edhe në fushën e transaksioneve me jashtë. Deficiti korent është zvogëluar në 5 për qind të PBB-së nga 7 për qind në vitin 2003. Përmirësimi i pozicionit të deficitit korent është ndikuar nga përmirësimi i ndjeshëm i bilancit tregtar. Deficiti tregtar (mallra dhe shërbime) vlerësohet të ketë arritur në 22 për qind të PBB-së, duke u zvogëluar me 3 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë. Hyrjet neto të kapitalit regjistruan një nivel rekord prej 531 milionë dollarësh, duke mundësuar plotësisht financimin e deficitit korent. Këto hyrje gjithashtu, kanë mundësuar një rritje të konsiderueshme të rezervës valutore, e cila arriti nivelin 1,374 miliardë dollarë në fund të vitit 2004. Rezerva valutore vlerësohet e mjaftueshme për të mbuluar rreth 5.1 muaj importe mallrash dhe shërbimesh. Stoku i borxhit të jashtëm⁴ të Shqipërisë, në fund të vitit, u rrit në 1.674 miliardë dollarë duke qenë i barazvlefshëm me 22 për qind të PBB-së nga 25 për qind në fund të vitit 2003.

Megjithë rritjen në vëllimin e transaksioneve të mallrave dhe të shërbimeve, gjatë vitit 2004, treguesi i hapjes ekonomike të Shqipërisë⁵ vlerësohet në rënie. Këtë vit hapja ekonomike e Shqipërisë ka shënuar nivelin 64 për qind nga rreth 66 për qind, që ishte në vitin 2003. Megjithëse Shqipëria, falë rritjes ekonomike prej 6 për qind për të dytin vit radhazi, vlerësohet si një ndër ekonomitë me zhvillim më të shpejtë në rajon, shkalla e hapjes ekonomike lë ende shumë për të dëshiruar në raport me vendet e rajonit.

Në vlerësimin e rezultateve të kësaj analize, duhet marrë në konsideratë fakti që një pjesë e rëndësishme e rritjes në vëllimin e transaksioneve, reflekton normën vjetore të zhvlerësimit të kursit të këmbimit të monedhës raportuese - dollarit amerikan - kundrejt euros (7.7 për qind) dhe kundrejt monedhës vendase lekut (15.7 për qind), regjistruar në vitin 2004. Si rezultat i luhatjeve të kursit të këmbimit si dhe i faktit që një numër i madh i transaksioneve midis rezidentëve dhe jorezidentëve kryhet në euro⁶ dhe jo në monedhën e

raportimit të bilancit të pagesave (usd), analiza e zhvillimeve aktuale duhet të mbajë parasysh edhe këtë efekt.

	2003	2004	2003	2004
	Në milionë usd		Në % ndaj PBB-së	
Llogaria korente	(407)	(358)	(7.1)	(4.7)
Bilanci tregtar	(1,336)	(1,592)	(23.4)	(21.0)
Eksport	447	603	7.8	7.9
Import	(1,783)	(2,195)	(31.3)	(28.9)
Shërbime (neto)	(83)	(51)	(1.5)	(0.7)
Të ardhura (neto)	170	175	3.0	2.3
Transferta korente (neto)	842	1,109	14.8	14.6
Llogaria kapitale (neto)	259	243	4.5	3.2
Bilanci i përgjithshëm	100	288	1.7	3.8


Tabelë 1. Treguesit kryesorë të bilancit të pagesave në raport ndaj PBB-së.

III.1. LLOGARIA KORENTE

Viti 2004 është karakterizuar nga një aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të konsiderueshme të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente. Vëllimi i transaksioneve korente është rritur me 28 për qind krahasuar me vitin 2003, duke shënuar një nivel prej 6.4 miliardë dollarësh. Mëse 96 për qind e shpenzimeve korente kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh. Rreth 40 për qind e të ardhurave korente kanë hyrë në formën e transfertave korente, ndërkohë që shërbimet dhe eksportet e mallrave kanë siguruar përkatësisht 33 për qind dhe 20 për qind të të ardhurave. Deficiti korent gjatë këtij viti paraqitet në rënie krahasuar me një vit më parë (rreth 12 për qind), duke shënuar 358 milionë dollarë dhe duke qenë i barazvlefshëm me rreth 5 për qind të PBB-së. Rritja e deficitit të tregtisë në mallra dhe në shërbime u balancua pjesërisht nga rritja e të ardhurave faktoriale neto. Eksporti i mallrave shfaq një ecuri të kënaqshme, megjithë mbiçmimin e kursit të këmbimit të lekut. Megjithëse norma vjetore e rritjes të eksporteve ishte më e lartë se ajo e importeve, vëllimi i lartë i këtyre të fundit bëri që deficitin tregtar të rritej me rreth 255 milionë dollarë ose me 19 për qind.

Llogaria e shërbimeve gjatë vitit 2004 ka regjistruar rritje si në kahun e të ardhurave, ashtu edhe në atë të shpenzimeve. Në krahasim me vitin 2003, të ardhurat janë rritur më tepër sesa shpenzimet. Rezultati neto i transaksioneve në shërbime ka çuar në zvogëlim të deficitit të kësaj llogarie me rreth 31 milionë dollarë. Bilanci pozitiv i hyrjeve korente në formën e transfertave dhe të ardhurave korente, vlerësohet të jetë rreth 272 milionë dollarë më i lartë, krahasuar me vitin e kaluar. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së të ardhurave korente në formën e prurjeve nga emigrantët, ndërkohë që, rënia e konsiderueshme në të ardhurat nga interesat mbi investimet e njësisve rezidente

Grafik 4. Shpërndarja e hyrjeve (të ardhurat) dhe e daljeve (shpenzimet) në llogarinë korente (në përqindje).




jashtë, ka bërë që bilanci pozitiv i llogarisë së të ardhurave të jetë lehtësisht në rritje, krahasuar me atë të vitit 2003.

Megjithë rritjen në vëllimin e transaksioneve të mallrave dhe të shërbimeve, gjatë vitit 2004, treguesi i hapjes ekonomike të Shqipërisë vlerësohet në rënie. Këtë vit hapja ekonomike e Shqipërisë ka shënuar nivelin 64 për qind nga rreth 66 për qind që ishte në vitin 2003. Megjithëse Shqipëria, falë rritjes ekonomike prej 6 për qind për të dytin vit radhazi, vlerësohet si një ndër ekonomitë me zhvillim më të shpejtë në rajonit, shkalla e hapjes ekonomike lë ende shumë për të dëshiruar në raport me vendet e rajonit.

III.1.1 TREGTIA E JASHTME

Transaksionet tregtare gjatë këtij viti kanë përfaqësuar mëse 44 për qind të shkëmbimeve korente midis Shqipërisë dhe botës. Vëllimi i përgjithshëm tregtar arriti në 2.8 miliardë usd, me një rritje vjetore prej 25 për qind. Të ardhurat nga eksporti i mallrave regjistruan 603 milionë usd, duke qenë 35 për qind më të larta se ato të vitit të kaluar. Shenjat e përmirësimit të ekonomisë evropiane, partnerit kryesor tregtar të Shqipërisë, si dhe ndryshimet strukturore brenda vendit duket se po japin efekt.

Megjithë përkeqësimin në termat e konkurrueshmërisë⁷, eksporti i mallrave është karakterizuar nga një rritje premtuese përgjatë dy viteve të fundit. Kontributi i eksporteve në PBB këtë vit vlerësohet në 7.9 për qind.



Eksportet për vitin 2004 mundën të financojnë 27.5 për qind të importeve nga 25 për qind në vitin 2003. Ekonomia shqiptare mbetet me orientim drejt importeve, të cilat gjatë vitit 2004, përfaqësuan 78 për qind të vëllimit të tregtisë së jashtme. Shpenzimet për importe mallrash vlerësohen rreth 2.2 miliardë usd. Rritja nominale vjetore prej 411 milionë dollarësh ose 23 për qind, tregon se edhe ky vit ka pasuar trendin e theksuar në rritje, që ka karakterizuar importet gjatë viteve 2000. Deficiti tregtar për vitin 2004 arriti në rreth 1.6 miliardë usd, duke qenë rreth 19 për qind më i lartë sesa ai i vitit paraardhës.

Pozicioni i deficitit tregtar ndaj PBB-së vlerësohet të jetë përmirësuar në 21 për qind nga 23.4 për qind në vitin paraardhës. Importet për vitin në fjalë kanë shënuar nivelin 28.9 për qind të PBB-së. Pakësimi i nevojave të brendshme për energji elektrike, nxitur nga kushtet e favorshme atmosferike si dhe përmirësimi i rrjetit shpërndarës e mirëadministrimi i energjisë elektrike, shoqëruar me një politikë të kujdesshme fiskale, kanë dhënë ndikimin e tyre në përmirësimin e pozicionit neto të tregtisë ndaj PBB-së.

Për një periudhë dhjetëvjeçare (Grafik III.7.), rritja mesatare vjetore e eksporteve (19 për qind) ka qenë më e shpejtë se ajo e importeve (13.3 për qind). Ndërkohë që, pas vitit 2001 vërehen tendenca më të larta rritjeje: eksportet për këtë periudhë janë rritur me një ritëm mesatar vjetor prej 24.4 për qind, ndërsa importet me 19.8 për qind. Duket se proceset e globalizimit dhe të rajonalizimit janë shoqëruar përgjithësisht me efekte pozitive për ekonominë e vendit.

- Eksporti i mallrave

Pavarësisht nga zhvillimet pozitive që kanë karakterizuar eksportin e mallrave gjatë këtij viti, struktura e tij vazhdon të vuajë shkallën e ulët të diversifikimit. Evidencat e strategjive të marketingut të bizneseve shqiptare drejt tregjeve të huaja janë shumë të pakta. I një rëndësie të veçantë shihet çertifikimi i prodhimeve me origjinë shqiptare për t'u përpunuar me standardet evropiane. Aktualisht, eksporti në masën më të madhe përfaqësohet nga eksporte të tekstileve dhe të veshjeve të këmbëve⁸, të produkteve minerale dhe të atyre bujqësore kryesisht bimë mjekësore. Kështu, edhe këtë vit, ecuria e eksportit të mallrave u përcaktua konsiderueshëm nga ndryshimet në industrinë e përpunimit në vend. Eksportet e kësaj kategorie realizuan rreth 75 për qind të të ardhurave vjetore në eksporte mallrash.

Karakteristikat e eksporteve (vëllimi i vogël dhe shkalla e ulët e diversifikimit) pasqyrojnë kapacitetin e kufizuar të ekonomisë vendase për të ofruar në tregun ndërkombëtar mallra konkurrues. Deficiti i lartë dhe rregullisht në rritje i tregtisë së jashtme, duhet të tërheqë vëmendjen drejt politikave që synojnë zëvendësimin e importeve dhe nxitjen e eksporteve.


Tabelë 2. Eksporti sipas klasifikimit SITC (në milionë usd).

Kodi	Përshkrimi	2002	2003	2004	2002	2003	2004	2004/2003
		Vlera në milionë usd			Struktura në %			Ndryshimi në %
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	5.2	18.9	24.8	1.6	4.2	4.1	31.3
1	Pije dhe duhan	6.2	5.8	9.4	1.9	1.3	1.5	61.2
2	Materiale të papërpunuara	13.3	19.4	23.0	4.0	4.3	3.8	18.4
3	Lëndë djegëse	7	4.9	16.2	2.1	1.1	2.7	231.0
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	0	0.5	0.3	0.0	0.1	0.1	-32.0
5	Prodhime kimike	2.2	2.9	3.5	0.7	0.6	0.6	22.1
6	Mallra të përpunuar	57.6	77.5	127.0	17.4	17.3	21.0	63.8
7	Makineri dhe pajisje	9.3	15.8	23.7	2.8	3.5	3.9	50.3
8	Mallra të tjerë të përpunuar	229.5	301.5	375.4	69.5	67.4	62.2	24.5
9	Mallra të paklasifikuara diku tjetër	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-
	TOTAL	330.2	447.2	603.3	100.0	100.0	100.0	34.9

Premtuese gjatë këtij viti, është rritja e eksporteve nga prodhimi vendas me tregje kryesisht drejt vendeve të rajonit, të nxitura nga marrëveshjet e tregtisë së lirë në rajon. Me një rritje vjetore prej rreth 48 milionë dollarë, eksporti i brendshëm e ka rritur nivelin e përfaqësimit në totalin e eksportit në 25 për qind, nga 23 për qind në vitin e kaluar.



Grafik 7. Eksporti nga prodhimi i brendshëm (në milionë usd).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Metalet bazë dhe produktet minerale zënë dhe peshën më të madhe në eksportin nga prodhimi vendas. Gjatë këtij viti ato kanë shfaqur rritje të konsiderueshme (respektivisht 90 për qind dhe 107 për qind). Impaktin më të madh në këtë rritje e kanë dhënë lëndët djegëse minerale që janë pothuajse dyfishuar, si dhe giza dhe çeliku. Gjithashtu, prirje pozitive ka shfaqur eksporti i ujit të pijshëm dhe birrës, kryesisht drejt vendeve të rajonit. Zhvillimi i sektorit privat gjatë viteve të tranzicionit ka kontribuar jo vetëm në rritjen e eksporteve që u evidentua në analizën e mësipërme, por dhe në zhvillimin e produkteve që konkurrojnë me produktet e importit. Në këtë mënyrë, kontributi në lehtësimin e deficitit tregtar realizohet nëpërmjet pakësimit të importeve.

- Importi i mallrave

Grafik 8. Eksporti nga prodhimi i brendshëm sipas grupmallrave (në milionë usd).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Variacioni në grupmallra dhe vëllimi i madh i importeve (28.9 për qind e PBB-së) pasqyrojnë kërkesën në rritje të vendit për mallra konsumi, mallra të ndërmjetëm dhe mallra kapitalë (shih boks 2). Kërkesa për importe mbetet e lartë, megjithatë pozitiv është fakti që, në masë të konsiderueshme, rritja vjetore në importe është shkaktuar nga rritja e importeve në makineri e pajisje dhe në mjete transporti. Importet në këto kategori, këtë vit, e kanë rritur nivelin e tyre të përfaqësimit në 24 për qind të shpenzimeve totale për importe nga 21 për qind në vitin paraardhës. Kërkesa e lartë e sektorit privat për mallra kapitalë, është një tregues pozitiv për nivelin e investimeve, për rinovimin e bazës teknologjike si dhe për produktivitetin e tij.

Sektorët më të përparuar, përsa i përket rinovimit të bazës teknologjike, janë ata të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit si dhe industria e ndërtimit. Importet e lëndës së parë për industrinë e përpunimit aktiv në vend, të përqëndruara kryesisht në sektorët e tekstileve, të veshjeve të këmbës dhe të metaleve, u rritën me rreth 13 për qind. Shpenzimet për importe të kësaj kategorie përfaqësojnë rreth 17 për qind të shpenzimeve totale në importe, realizuar gjatë vitit 2004. Ecuria e këtyre importeve reflekton zhvillimet e vërejtura në sektorin e rieksperteve.

Pavarësisht nga zhvlerësimi i ndjeshëm i dollarit amerikan, rritja e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare ka mbajtur të larta shpenzimet për importet e karburanteve. Kërkesa e brendshme për këto të fundit mbetet e lartë, edhe pse ajo ka shënuar një rënie të lehtë ndaj një viti më parë. Sasia e importuar gjatë vitit 2004 vlerësohet vetëm 2.4 për qind më e ulët krahasuar me vitin

2003, ndërkohë që, si pasojë e rritjes së çmimit të saj, shpenzimet vjetore për importin e karburanteve janë rritur me rreth 15 për qind. Ecuria pozitive e prodhimit të energjisë elektrike në vend gjatë vitit 2004, solli një rënie të importeve në energji elektrike në krahasim me vitin paraardhës.

Tabelë 3. Importi sipas klasifikimit SITC (në milionë usd).

Kodi	Përshkrimi	2002	2003	2004	2002	2003	2004	2004/2003
		Vlera në milionë usd			Struktura në %			Ndryshimi në %
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	218.4	268.1	331.3	14.7	14.4	14.5	23.6
1	Pije dhe duhan	56.6	68.8	76.1	3.8	3.7	3.3	10.7
2	Materiale të papërpunuara	58.1	63.7	73.0	3.9	3.4	3.2	14.6
3	Lëndë djegëse	136.2	158.9	176.6	9.2	8.6	7.7	11.1
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	20.8	29.0	33.0	1.4	1.6	1.4	13.8
5	Prodhime kimike	122.1	159.7	207.1	8.2	8.6	9.1	29.7
6	Mallra të përpunuar	338.5	441.0	531.8	22.8	23.7	23.3	20.6
7	Makineri dhe pajisje	321.3	403.4	538.4	21.6	21.7	23.6	33.5
8	Mallra të tjerë të përpunuar	215.2	264.7	312.6	14.5	14.3	13.7	18.1
9	Mallra të paklasifikuara diku tjetër	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-
	TOTAL	1,487.3	1,857.2	2,280.0	100.0	100.0	100.0	22.8

Boks 2. Përpilimi dhe analiza e importeve sipas BEC. Çfarë është BEC (Broad economic categories)?

Klasifikimi i tregtisë së jashtme sipas kategorive ekonomike (BEC) ofron për përdoruesit dhe analizuesit e këtyre statistikave kategorizimin e tregtisë sipas qëllimit përfundimtar të përdorimit - mallra kapitalë, mallra të ndërmjetëm dhe mallra për konsum – që përfaqësojnë 3 klasat bazë të Sistemit të Llogarive Kombëtare. Në këtë mënyrë, ky klasifikim lejon studimin e statistikave të tregtisë së jashtme në harmonizim me komponentët e tjerë të statistikave të përgjithshme siç janë statistikave industriale dhe agregatët e të ardhurave kombëtare. Kodet e BEC mund të grupohen në mallra primare (të dorës së parë) dhe mallra të përpunuar. Në rast se nuk është i mundur përcaktimi i plotë i produktit sipas destinacionit përfundimtar, atëherë kodi vendoset sipas destinacionit mbizotërues. Mallrat kapitalë shërbejnë për prodhimin e mallrave dhe shërbimeve dhe nuk janë pjesë e tyre për shembull, mjetet e transportit, pajisjet e zyrës etj.. Mallrat e ndërmjetëm përdoren ose transformohen për prodhimin e mallrave dhe të shërbimeve përfundimtare. Të tilla përmendim importet e lëndëve kimike, naftën e papërpunuar etj..


Nëpërmjet një korrelacioni një më një, kodet e mallrave në Sistemin e Harmonizuar (HS) të tregtisë së jashtme janë harmonizuar me kodet e BEC. Një klasifikim i tillë për të dhënat tona të tregtisë së jashtme është i mundur duke filluar nga viti 2003.

	2003	2004	2004/2003	2003	2004
	Vlera në milionë usd		Ndryshimi në %	Struktura në %	
Mallra kapitalë	215.5	292.7	35.8	11.6	12.8
Mallra të ndërmjetëm	863.3	1029.3	19.2	46.3	45.1
Mallra për konsum	635.0	749.5	18.0	34.1	32.9
Total	1857.2	2280.0	22.8	100.0	100.0

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme struktura e importeve tona mbizotërohet prej mallrave të ndërmjetëm, të cilët gjatë vitit 2004 kanë përfaqësuar 45 për qind të totalit të importeve. Rritja nominale prej rreth 166 milionë usd ndaj një viti më parë, flet për një zhvillim pozitiv të industrisë së përpunimit në vend. Gjithashtu, pozitivisht vlerësohet ecuria e mallrave kapitalë, si një tregues optimist për nivelin e investimeve, për rinovimin e bazës teknologjike, të transportit etj.. Vërejmë që, kategoria e mallrave të konsumit vazhdon të ruajë një peshë të konsiderueshme në importet totale rreth 33 për qind. Një paraqitje më të detajuar të statistikave të importit tregtar sipas klasifikimit BEC do ta gjeni në aneksin bashkëngjitur.

- Tregtia nga industria e përpunimit aktiv


Tashmë prej vitesh, industria përpunuese (me material porositësi) është përcaktuesi kryesor në aktivitetin tregtar të Shqipërisë, tregues ky pozitiv i zgjerimit të kapaciteteve prodhuese. Me fillesa në vitin '96, i cili përfaqëson vitin me hapjen e shumë subjekteve të industrisë përpunuese në vend, ky aktivitet ka ardhur në rritje nga viti në vit.



Vlera e shtuar e mallrave nga përpunimi ka sjellë rritje të konsiderueshme të suficitit të kësaj industrie, sidomos përgjatë dy viteve të fundit. Gjatë këtij viti, fluksi neto vlerësohet në rreth 77 milionë usd nga 11 milionë në vitin 2003. Me një vëllim prej 831 milionë dollarësh, tregtia nga industria e përpunimit aktiv në vend zë rreth 29 për qind të transaksioneve tregtare të zhvilluara gjatë këtij viti.

Më i ndjeshëm është ndikimi në eksporte, me rreth 75 për qind, ndërkohë që, importet lëndë e parë për përpunim të mëtejshëm, zunë rreth 17 për qind në importet totale. Kundrejt vitit të kaluar eksportet janë rritur më shpejt sesa importet lëndë e parë.

Industria e përpunimit me material të porositësit prezantohet përgjithësisht me aktivitetin e subjekteve me kapital të huaj, organizuar në kompani të vogla dhe të mesme. Aktiviteti është përqëndruar kryesisht në përpunimin e artikujve tekstilë, të veshjeve të këmbës dhe të metaleve. Investitorët kryesorë në këtë industri vijnë nga Italia dhe Greqia.



- Tregtia sipas partnerëve tregtarë

Duke tërhequr 90 për qind të totalit të eksporteve, Bashkimi Evropian, mbetet destinacioni kryesor i prodhimeve shqiptare. Shitjet në tregjet evropiane kanë regjistruar një rritje vjetore prej 215 milionë dollarësh ose prej 30 për qind ndaj vitit të kaluar. Megjithatë, ky treg ka humbur terren në favor të zgjerimit të tregut në vendet e rajonit.

Eksporti	Pesha në totalin e eksportit			Ndryshimi (2004/2003)
	2002	2003	2004	%
Total	100,0	100,0	100,0	34,9
Vendet e BE – 15	92,1	93,3	89,9	30,1
Itali	71,7	74,9	73,1	31,6
Greqi	12,8	12,9	12,0	25,7
Gjermani	5,5	3,4	3,1	23,2
Vendet e Evropës Juglindore*	3,3	3,2	6,6	177,2
Nga të cilat:				
Ish – Jugosllavia	2,2	2,4	4,9	179,3
IRJ e Maqedonisë	1,5	0,7	1,2	144,4
Vende të tjera	4,5	3,5	3,5	32,4

Tabelë 4. Shpërndarja e eksporteve sipas partnerëve tregtarë në vite, ndryshimi vjetor për vitin 2004.

* Përfaqësojnë vendet me të cilat Shqipëria ka Marrëveshje të Tregtisë së Lirë.

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Bosnje-Hercegovinën, në dhjetor të vitit 2004, Shqipëria ka plotësuar kuadrin dypalësh të Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë në rajon. Eksportet me vendet e rajonit të Evropës Juglindore, të përfshira në procesin e krijimit të zonës së lirë tregtare, janë rritur me 2.3 herë kundrejt një viti më parë, duke e zgjeruar tregun e eksporteve shqiptare në këtë zonë nga 3 në 7 për qind të totalit të eksporteve. Kosova dhe Maqedonia përfaqësojnë tregun më të madh për eksporte të prodhimeve shqiptare.

Gjithashtu, tregtia me Turqinë shihet se ka marrë interes për prodhimet shqiptare. Totali i shitjeve me këtë vend u rrit nga 3.7 milionë usd në 11.3 milionë dollarë në vitin 2004.

Përsa i përket importeve, gjeografia tregtare paraqet një larmi më të madhe tregjesh. Bashkimi Evropian plotëson rreth 65 për qind të nevojave të brendshme për importe. Importi total nga ky grupim (1.5 miliardë dollarë) u rrit me rreth 17 për qind krahasuar me një vit më parë. Italia dhe Greqia mbeten partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë.

Importet nga të dyja shtetet së bashku përfaqësojnë 79 për qind të shpenzimeve të ekonomisë shqiptare në tregjet e Bashkimit Evropian. Importet me vendet e rajonit të Evropës Juglindore të përfshira në procesin e krijimit të zonës të lirë tregtare, kanë shfaqur një rritje të moderuar. Importet në këtë grupim janë rritur me rreth 9 për qind, ndërkohë që raporti i këtyre importeve ndaj importeve të përgjithshme ka rënë në nivelin 5.7 për qind nga 6.4 për qind që u regjistrua në vitin 2003.

Tabelë 5. Shpërndarja e importeve sipas partnerëve tregtarë në vite, ndryshimi vjetor për vitin 2004.

Importi	Pesha në totalin e importit			Ndryshimi (2004/2003)	
	2002	2003	2004	%	
Total	100.0	100.0	100.0	22,8	
Vendet e BE* – 15	71,1	68,3	65,0	16,8	
Italia	34,7	34,1	32,6	17,4	
Greqia	21,9	19,8	18,6	15,4	
Gjermania	5,6	5,7	6,2	33,7	
Vendet e Evropës Juglindore**	7,7	6,4	5,7	9,4	
Bullgaria	2,0	2,5	2,0	-2,4	
Bosnja - Hercegovina	0,0	0,1	0,0	-8,0	
Kroacia	2,3	1,5	1,3	5,2	
Ish - Jugosllavia	1,1	0,6	0,7	51,6	
Maqedonia	1,3	0,9	1,0	45,7	
Rumania	0,9	0,8	0,4	-32,7	
Moldavia	0,0	0,0	0,1	452,9	
Turqia	6,1	6,5	7,1	34,1	
Rusia	2,6	2,9	2,8	18,5	
Ukrahina	1,2	2,3	2,5	33,4	
Vende të tjera	11,3	13,6	16,9	51,0	

* Në maj të vitit 2004 Bashkimit Evropian lu shruan edhe 10 vende të reja anëtare (Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Qipro, Republika Çeke, Republika Sllovaqe dhe Sllovenia) duke zgjeruar grupin në 25 vende anëtare. Për konsistencë analize në grupimin e Bashkimit Evropian nuk janë përfshirë shtetet e reja anëtare.

** Përfshihen vendet me të cilat Shqipëria ka Marrëveshje të Traktatit të Lirë.

III.1.2 SHËRBIMET

Tregtia në shërbime është shndërruar në një element të rëndësishëm të integritimit global. Me hapjen graduale të vendit drejt një ekonomie të tregut të lirë, shkëmbimi i mallrave dhe shërbimeve u shndërrua në një fenomen gjithnjë e më të pranishëm. Shërbimet gjatë vitit 2004 arritën të kapin rreth 46.3 për qind të PBB-së, duke mbizotëruar prirjen e përgjithshme të këtij treguesi.

Eksporti neto i shërbimeve për vitin 2004 u vlerësua në -51 milionë dollarë, krahasimisht më i ulët se ai prej -82.7 milionë dollarësh, i regjistruar në fund të vitit 2003. Të ardhurat nga eksporti i shërbimeve, gjatë këtij viti u rritën me 39 për qind, ndërsa shpenzimet me 31 për qind në krahasim me vitin 2003. Ngushtimi i deficitit në shërbime i dedikohet rritjes së të ardhurave neto në zërin "udhëtime", që ka amortizuar, gjithashtu, deficitet e krijuara në përbërësit e tjerë të shërbimeve. Përshpejtimi i aktivitetit ekonomik në sektorin e shërbimeve të ofruara dhe/apo të kërkuara jorezidentëve, përbën një tregues pozitiv në ecurinë e hapjes dhe të integritimit të ekonomisë shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Ndërgjegjësimi i aktorëve të ekonomisë tonë për të rritur cilësinë dhe për të zgjeruar gamën e shërbimeve që ata ofrojnë për jorezidentët, duhet vlerësuar pozitivisht. Në vitet e fundit bilanci i pagesave ka regjistruar aktivitet të dyanshëm (import/eksport) në grupe shërbimesh, që më parë kanë qenë pothuajse të paeksploruara. Kështu, zëri shërbime të tjera – të gjitha shërbimet përjashtuar shërbime transporti dhe udhëtimi - këto vitet e fundit ka përfaqësuar mesatarisht në masën 41 për qind totalin e transaksioneve në shërbime, nga 20 për qind që ai zinte në vitet '99.


Karakteristikë e zhvillimeve në bilancin e shërbimeve është regjistrimi i flukseve neto pozitive në zërin “udhëtime”, të cilat kanë amortizuar pjesërisht apo totalisht bilancet negative në të tjera kategori shërbimesh.

- Shërbime udhëtimi

Lëvizjet në llogarinë e shërbimeve janë influencuar ndjeshëm nga zhvillimet në shërbime për “turizëm” (udhëtime). Bilanci pozitiv i kësaj kategorie është rritur ndjeshëm krahasuar me vitin paraardhës. Aktualisht, aktiviteti i turizmit përfaqëson një nga burimet kryesore të të ardhurave në valutë për ekonominë shqiptare. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, eksporti në turizëm, gjatë vitit 2004 ka gjeneruar rreth 735 milionë dollarë flukse të ardhurash, një vlerë kjo rreth 22 për qind më e lartë se vlera e eksporteve të mallrave. Përveç ndikimit të luhatjeve në kursin e këmbimit euro/dollar, duke patur parasysh faktin që pagesat për shërbimet e turizmit janë kryesisht në euro⁹, rritja vjetore e të ardhurave nga turizmi është influencuar gjithashtu, nga rritja e numrit të shtetasve të huaj dhe e emigrantëve që kanë vizituar vendin, si edhe nga rritja e lehtë e shpenzimeve të tyre ditore. Gjatë vitit 2004, numri i shtetasve të huaj që kanë vizituar Shqipërinë është rritur me 16 për qind, në krahasim me vitin 2003. Veçanërisht në rritje vlerësohet fluksi i turistëve nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi. Aktivitet është vërejtur edhe në kahun e shpenzimeve për turizëm, të cilat vitet e fundit kanë shfaqur norma vjetore rritjeje më të larta. Rezidentët shqiptarë kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 642 milionë dollarë ose sa 62 për qind e totalit të dërgesave nga emigrantët.

Në vitet e fundit turizmi ka përfaqësuar në shkallë të konsiderueshme hyrjet në valutë nga shkëmbimet në mallra dhe shërbime, në një amplitudë 45 deri në 55 për qind. Fluksi i të ardhurave nga turizmi, i shprehur në raport me PBB-në, arriti nivelet më të larta (rreth 11 për qind) përgjatë viteve 2000 – 2002. Për vitin 2004 ai vlerësohet në 9.7 për qind të PBB-së. Megjithatë, jo të gjitha të ardhurat nga turizmi mbetën në ekonominë shqiptare. Në fakt, duhet konsideruar një dalje e të ardhurave valutore për sigurimin e një pjese të mallrave dhe shërbimeve të konsumuara nga vizitorët e huaj, për mallra kapitalë të investuar në turizëm si dhe për pagesa të tjera jashtë. Kërkesa për importe varet nga niveli i zhvillimit si dhe nga shkalla e diversifikimit të ekonomisë shqiptare. Këto nevoja janë, gjithashtu, të varura në mundësinë e sigurimit të zëvendësimit të prodhimeve të importuara si dhe në nivelin cilësor të ofertës turistike të vendit.

Është shumë e rëndësishme dhe e nevojshme të përcaktohet një sistem masash i cili do të mund të konsiderojë, gjithashtu, këto efekte për një vendimmarrje më të mirë përse i përket turizmit ndërkombëtar. Gjatë këtij viti, të ardhurat neto nga turizmi kanë financuar deficitin tregtar në mallra vetëm



në masën 5.6 për qind, për vitin 2004 nga 2.5 për qind në vitin 2003. Niveli më i lartë i financimit të importit neto nga të ardhurat neto të turizmit është regjistruar në vitin 1999, me rreth 30 për qind, i cili përfaqëson edhe vitin me të ardhurën neto më të lartë të kësaj kategorie.

Turizmi, gjithnjë e më shumë po shihet si një burim mbështetës për llogarinë korente. Përmirësimi i shërbimeve turistike brenda vendit duke i bërë ato më tërheqëse, përmirësimi veçanërisht i infrastrukturës përkatëse do të vepronte njëherësh si në rritjen e të ardhurave ashtu edhe në pakësimin e shpenzimeve të këtij sektori. Megjithë konkurrencën e fortë nga vendet e rajonit (Greqia, Mali i Zi, Kroacia) dhe mungesën e subvencionimeve, sektori i turizmit ka potencialin të kontribuojë pozitivisht në rritjen ekonomike. Një tjetër aspekt nxitës për politikën e zhvillimit në këtë sektor është fakti që, përveç marketingut ndërkombëtar, nevoja kryesore e turizmit është infrastruktura, ndërtimi dhe modernizimi i të cilës është një kërkesë jo vetëm e këtij sektori por e të gjithë ekonomisë.

Boks 3. Vrojtimi i turizmit – rezultatet për vitin 2004.

Turizmi ndërkombëtar i shprehur në vlera të konsiderueshme gjatë viteve të fundit, paraqet rëndësi për bilancin shqiptar të pagesave. Për të patur një vlerësim sa më afër realitetit lidhur me flukset hyrëse dhe dalëse që gjeneron turizmi, sektori i bilancit të pagesave ka parë si domosdoshmëri kryerjen e 'Vrojtimin të Turizmit'. Metoda e vlerësimit të këtyre flukseve me anë të vrojtimeve statistikore është një praktikë e ndjekur gjërësisht nga bankat qendrore për hartimin e statistikave të bilancit të pagesave. Përvojat e vendeve të ndryshme tregojnë se vrojtime të tilla harmonizohen me statistika të tjera të raportuara pranë bankave qendrore, lidhur me netët turistike të shpenzuara nga turistët e huaj në vend, të dhënat mbi origjinën dhe shpenzimet. Për rastin tonë statistika të tilla është e pamundur të sigurohen. Krijimi i një rrjeti të tillë informacioni do t'i shërbente përmirësimit të sistemit statistikor si dhe do të mundësonte identifikimin e përparësive konkurruese të vendit, nivelit të kërkesës për shërbime turistike etj., duke kontribuar para së gjithash në rritje të saktësisë së matjes së flukseve monetare që sjell aktiviteti turistik në vend. Gjithashtu, statistikën e përfutur nga raportimet mujore të sistemit bankar pranë Bankës së Shqipërisë, vënë në dukje se një pjesë relativisht e vogël e pagesave për turizmin kanalizohen në sistemin bankar.

"Vrojtimi i turizmit" i ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Institutin e Statistikave, që prej vitit 1999 është bazë e metodologjisë së vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve për turizmin.

Nën një frekuencë tremujore përgjatë vitit, rreth 4000 udhëtarë i nënshtrohen intervistimit të drejtpërdrejtë në portet – pikat kufitare - kryesore të Republikës së Shqipërisë. Popullata nën vërtetim përfshin rezidentët shqiptarë që kthehen nga udhëtimi jashtë dhe udhëtarët jorezidentë që largohen nga Shqipëria. Qëllimi kryesor i vërtetimit konsiston në llogaritjen e koeficientëve vlerësues të ditëqëndrimit dhe shpenzimit mesatar ditor për turist. Këta koeficientë më pas kombinohen me statistikat e hyrje-daljeve të turistëve të ndarë sipas kombësisë në shqiptarë dhe të huaj, të siguruar nga Ministria e Rendit Publik. Problematika e hasur në mënyrë të vazhdueshme lind

nga mospërputhja e kriterit të regjistrimit të udhëtarëve nga Ministria e Rendit Publik me atë të bilancit të pagesave. Duke patur parasysh që vendi ynë karakterizohet nga një fluks i madh emigrantësh, të cilët regjistrohen nisur nga koncepti i kombësisë dhe jo ai i rezidencës, është parë e nevojshme të modifikohet numri i shqiptarëve që hyjnë në Shqipëri.

Përpunimi i të dhënave bëhet sipas dy grupimeve të mëdha, për qëllime biznesi dhe personale. Në përfundim të analizës përftohen të ardhurat dhe shpenzimet totale për turizmin, të cilat paraqiten në zërin "udhëtim" nën kategorinë shërbime të llogarisë korente.

Arsyet e udhëtimit të vizitorëve të huaj në Shqipëri kushtëzohen nga periudhat e vitit. Periudha e verës karakterizohet nga turistë që udhëtojnë për pushime, ndërkohë që pjesa tjetër e vitit karakterizohet nga turistë që lëvizin për qëllime biznesi dhe për qëllime të tjera. Bazuar në rezultatet e vërtetimit të ndërmarrja gjatë vitit 2004, në krahasim me vitin 2003, ditëqëndrimi i turistëve shqiptarë jashtë ka ardhur lehtësisht në rritje për ata që udhëtojnë për qëllime biznesi (mesatarisht 5 ditë) dhe vlerësohet rreth të njëjtit nivel për ata që udhëtojnë për qëllime personale (mesatarisht 11 ditë).

Nga analiza e rezultateve të vërtimit, përsa i përket shpenzimeve mesatare ditore gjatë vitit 2004, shpenzimet e udhëtarëve të huaj për qëllime biznesi në Shqipëri kanë ardhur në rritje, ndërkohë që kategoria biznes e udhëtarëve shqiptarë jashtë, ka shfaqur shpenzime relativisht më të ulëta krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë që, shpenzimet mesatare vjetore për qëllime personale kanë ardhur lehtësisht në rritje, si për udhëtarët e huaj ashtu edhe për ata shqiptarë.

Në përfundim të vlerësimit të koeficientëve sasiorë të dalë nga vërtimi është mundësuar vlerësimi i shërbimeve të udhëtimit në: të ardhura nga turizmi 735 milionë usd dhe shpenzime për turizëm në 642 milionë usd.

- Shërbime transporti dhe sigurimi

Shërbimet e transportit dhe ato të sigurimit përgjithësisht, ndjekin zhvillimet në aktivitetin tregtar të mallrave. Rritja e vëllimit të importit ka shkaktuar rritjen e importit të shërbimeve të këtyre kategorive. Njëkohësisht, pjesëmarrja gjithnjë e më e madhe e shoqërive rezidente të transpedicionit, që ofrojnë shërbime në tregtinë e jashtme, ka rritur ndjeshëm të ardhurat e kësaj kategorie. Megjithatë, në fund të vitit, deficitet në shërbime transporti dhe sigurimi vlerësohen në rritje ndaj vitit të kaluar.

Nisur nga pozicioni i favorshëm gjeografik, vendi ynë zotëron një përparësi konkurruese, atë të transportit detar. Krijimi i Kodit Detar për Shqipërinë, gjatë vitit 2004, është një sinjal pozitiv për integrimin dhe konkurrimin e këtij sektori në tregun ndërkombëtar¹⁰.

Tregut të shërbimeve të sigurimeve, gjatë vitit 2004, i janë shtuar edhe pesë kompani të reja sigurimi, duke e rritur numrin e kompanive në dhjetë të tilla. Ky fakt tregon një ofertë më të lartë në këtë sektor duke sjellë çmime konkurruese dhe përmirësimin në cilësinë e produkteve të ofruara¹¹.

- Shërbime të tjera

Kategoria “shërbime të tjera” ka regjistruar një deficit prej rreth 20 milionë dollarësh, duke mbetur afër të njëjtit nivel të deficitit të një viti më parë. Gjatë vitit 2004, kjo kategori ka gjeneruar një fluks të ardhurash prej 163 milionë dollarësh ose 30 për qind më shumë të ardhura se sa viti paraardhës.

Ndërkohë, shpenzimet për këtë grup shërbimesh arritën në 183 milionë usd me një rritje vjetore prej 35 për qind. Deficiti i sivjetshëm është shkaktuar kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit të shpenzimeve qeveritare si dhe e rritjes së deficitit në kategoritë shërbime kulturore dhe shërbime biznesi. Shërbimet qeveritare kanë një natyrë të veçantë, pasi këto shërbime zakonisht nuk janë të tregtueshme. Shpenzimet për shërbime qeveritare janë vlerësuar në rritje kundrejt vitit 2003 (50 për qind).


Një rritje e ndjeshme është regjistruar në të ardhurat nga shërbimet e telekomunikacionit, kategori e cila u mbyll me një bilanc pozitiv prej 54 milionë usd nga 27 të regjistruara gjatë vitit të kaluar. Rritja në të ardhurat e kësaj kategorie, e cila parashikohet të vazhdojë me ritme të larta edhe në të ardhmen, ka ardhur si pasojë e zgjerimit të gamës së prodhimeve që kanë ofruar subjektet e telekomunikacionit.

III.1.3 TË ARDHURAT

Të ardhurat dhe shpenzimet nga faktorët e prodhimit – puna dhe kapitali, përcaktojnë profilin e të ardhurave. Çdo vit ekonomia shqiptare përfiton burime valutore prej punës së punonjësve sezonalë dhe investimeve të rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente, duke paguar njëkohësisht interesa për borxhin e jashtëm. Bilanci pozitiv i të ardhurave në fund të vitit 2004, vlerësohet rreth 175 milionë duke qenë 5 milionë më i lartë ndaj vitit 2003. Rritja e kërkesës për fuqi punëtore në Greqi gjatë organizimit

të Lojërave Olimpikë të vitit 2004, ndikoi në rritje të të ardhurave nga puna. Të ardhurat nga puna, të cilat vlerësohen si një pjesë e prurjeve të emigrantëve, nën supozimin që një pjesë e numrit të përgjithshëm të emigrantëve futet në kategorinë e punonjësve sezonalë apo kufitarë, përfaqësojnë rreth 75 për qind të bilancit pozitiv të të ardhurave. Fluksi neto i të ardhurave të kësaj kategorie u rrit me rreth 21 milionë dollarë dhe kapi shifrën 132 milionë usd.


Ndërkohë, të ardhurat në formën e interesit nga investimet pësuan rënie (rreth 13 milionë dollarë). Shqipëria gjatë vitit 2004 ka paguar 22 milionë dollarë për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm ose 27 për qind më shumë se në vitin e kaluar.



III.1.4 TRANSFERTAT KORENTE

Transfertat korente, ashtu si edhe gjatë viteve të kaluara, kanë marrë formë prej prurjeve nga emigrantët. Këto të fundit, gjatë vitit 2004, janë vlerësuar në nivelin 1028 milionë dollarë duke qenë 32 për qind më të larta se ato të vitit të kaluar. Nisur nga fakti që në masën më të madhe këto transferta janë në euro, rritja vjetore pjesërisht i atribuohet ndikimit të fortë të zhvlerësimit të monedhës raportuese – usd – ndaj monedhës së origjinës së prurjeve – euro - gjatë vitit 2004 krahasuar me vitin paraardhës. Prurjet e emigrantëve përfaqësojnë një burim të rëndësishëm mbështetës për ekonominë shqiptare, duke siguruar një fluks të vazhdueshëm financimi për deficitin korent. Totali i dërgesave nga emigrantët, për vitin 2004 ishte rreth 13.5 për qind e PBB-së. Kontributi i transfertave në zbutjen e deficitit tregtar llogaritet në rreth 65 për qind. Prurjet nga emigrantët janë shoqëruar edhe nga transferta shtetërore, kryesisht në formë të asistencës teknike (56 milionë usd), të cilat vlerësohen në rritje (12 për qind).

Gjatë viteve 2000 remitancat janë shfaqur në nivele të larta dhe në rritje të vazhdueshme. Ky zhvillim është shoqëruar, gjithashtu, me rritje të vëllimeve të remitancave të kanalizuar në rrugë zyrtare. Duket se ky rrjet ka fituar mirëbesimin emigrantëve shqiptarë për transferimin dhe kursimin e parave të tyre. Zhvillimi i sistemit bankar në Shqipëri është një tregues i rëndësishëm në ecurinë e remitancave të thithura në rrugë zyrtare. Kështu, vetëm përgjatë vitit 2004 janë hapur 30 degë të reja dhe agjenci bankare në të gjithë vendin. Gjithashtu, politikat e ndërmarra nga vendet pritëse për eliminimin e emigracionit ilegal mund të kenë ndikuar në sa më sipër.



III.2. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Ndërkohë që transaksionet në mallra dhe shërbime paraqiten në llogarinë korente të bilancit të pagesave, shitje/blerjet ndërkombëtare të mjeteve financiare shfaqen në llogarinë financiare, një nëndarje e llogarisë kapitale dhe financiare. Llogaria kapitale dhe financiare tregon mënyrën sesi transaksionet e bilancit të pagesave të një ekonomie janë financuar. Kursimet e ekonomisë shqiptare janë më të ulëta se investimet, për rrjedhim ajo është një importuese neto në mallra dhe shërbime. Këto importe neto duhet të financohen nga flukse financiare nga jashtë.

Në fillim të tranzicionit, flukset e kapitalit ndërmjet kufijve i përkisnin kryesisht sektorit shtetëror. Progresi i tranzicionit është shoqëruar nga një zhvendosje në përbërjen e flukseve të kapitalit, duke lëvizur nga sektori shtetëror në atë privat. Ndërkohë që huamarrësit publikë mbajnë një pretendim të matur të flukseve hyrëse të kapitalit për të financuar deficitin fiskal dhe investime të

tjera publike, njësitë private po rrisin integrimin e tyre në tregjet kapitale. Pjesa më e madhe e këtyre flukseve hyrëse konsiston në IHD, por gjithmonë e më shumë sipërmarrja private po merr pjesë në aksesin e formave të tjera të kapitalit, si borxhe bankare dhe letra me vlerë ndërkombëtare. Shtrirja e aksesit për një brez më të gjerë të instrumenteve dhe të burimeve investuese mund të ndihmojë në rritjen e mundësive investuese dhe rrjedhimisht, në rritjen ekonomike.

Lëvizjet e kapitalit, gjatë vitit 2004, rezultuan në një fluks neto prej 531 milionë dollarësh, duke mundësuar plotësisht financimin e deficitit korent, si dhe kontribuan në rritje të rezervave valutore. Transferrat kapitale kanë shënuar 132 milionë dollarë ose 25 milionë më pak krahasuar me fundin e vitit 2003, ndërkohë që llogaria financiare u mbyll me një bilanc pozitiv prej rreth 400 milionë dollarësh. Ky import kapitalesh, i realizuar në masën më të madhe prej thithjes së investimeve të huaja direkte dhe prej lëvrimeve të kredive afatgjata e të zbutura nga jashtë, ka shkaktuar rritje të detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës, me rreth 558 milionë usd. Kjo vlerë është rreth 70 për qind më e lartë se sa bilanci i vitit të kaluar.

III.2.1. NATYRA DHE PËRBËRJA E FLUKSEVE SHQIPTARE TË KAPITALIT.

Flukset në llogarinë financiare ndahen në mes të tre kategorive kryesore – investime direkte, investime portofoli dhe investime të tjera.




- Investimet direkte

Investimet direkte përcaktohen si një kategori e investimeve ndërkombëtare në të cilën një njësi rezidente në një ekonomi (investitori direkt) ndërmerr një interes të qëndrueshëm në një kompani rezidente të një ekonomie tjetër. Investimi direkt nënkupton një marrëdhënie afatgjatë mes investitorit direkt dhe kompanisë së investimit direkt, dhe një shkallë të konsiderueshme influence të investitorit në kompani (manuali i Bilancit të Pagesave botimi i 5^{te} i FMN-së rekomandon një minimum pjesëmarrjeje në kapital prej 10 për qind).

IHD-të vlerësohen si një burim i rëndësishëm për mbulimin e deficitit korent dhe të atij fiskal (në rastin e IHD-ve që rrjedhin nga privatizimi).

Gjithashtu, krahasuar me mundësitë e tjera të financimit, IHD-të mundësojnë transferimin e teknologjisë dhe të përhapjes së njohurive, ndikojnë në hapjen e vendeve të reja të punës, ndihmojnë kompanitë e brendshme të zgjerohen në tregjet e huaja etj..

Investimet e huaja direkte janë shndërruar në një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare të vendit. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, ka qenë privatizimi i sektorëve strategjikë ai që ka përcaktuar madhësinë dhe karakterin e investimeve të huaja në vend. Megjithëse Shqipëria paraqet relativisht më pak kufizime ndaj veprimtarisë së investitorëve të huaj në krahasim me shtetet e tjera të Evropës Juglindore, ajo duket të ketë tërhequr më pak investime direkte në krahasim me vendet e rajonit. I vënë në raport me totalin e hyrjeve në formën e transfertave korente dhe të hyrave në formën e kredive dhe të investimeve të huaja, totali i investimeve direkte të huaja të realizuara përbën një shifër shumë të ulët.



Fluksi hyrës i investimeve të huaja direkte përgjatë vitit 2004 arriti në 341 milionë dollarë, në sajë të progresit në programet e privatizimit, veçanërisht të Bankës së Kursimeve.

- Investimet e portofolit

Në vendin tonë mjetet financiare në formën e investimeve të portofolit – të përfaqësuar në letra me vlerë të borxhit - janë regjistruar për herë të parë në vitin 2000. Karakteristika thelbësore e këtyre instrumenteve është që ato janë të tregtueshme. Investimet e portofolit ofrojnë tek investitorët fleksibilitet për zhvendosje – pavarësisht nga maturiteti- të kapitalit nga një instrument në një tjetër. Gjatë pesëvjeçarit 2000-2004 ato kanë pasur një trend rritës dhe në fund të vitit 2004 stoku i tyre shënon 146 milionë dollarë. Investimet e portofolit¹² në vendin tonë konsistojnë në blerjen e mjeteve financiare, kryesisht bonot e thesarit të emetuara nga qeveri të huaja, nga njësitë rezidente, përfaqësuar tërësisht nga bankat e nivelit të dytë.

Flukset neto të këtyre investimeve gjatë vitit 2004 u rritën me 4 milionë dollarë amerikanë ose ishin rreth 6 herë më të ulëta në krahasim me vitin e kaluar. Gjatë vitit 2004, sidomos në tremujorin e tretë, vihen re luhatje të cilat janë pasojë e politikave investuese që ndjekin bankat e nivelit të dytë, konkretisht në kalime nga investime portofoli në depozita dhe anasjelltas. Në përbërjen strukturore sipas monedhave, investimet e portofolit gjatë këtij viti, mbizotërohen nga ato në euro, në rreth 71 për qind. Zhvlerësimi i vazhdueshëm i monedhës amerikane gjatë këtyre dy viteve të fundit, ka bërë që letrat me vlerë të borxhit në dollarë amerikanë të jenë më pak të preferuara duke zënë 28 për qind nga 84 për qind që ato zinin në fund të vitit 2003.

Stoku i mjeteve financiare në formën e investimeve të portofolit kapi shumën 146 milionë dollarë, duke shënuar një rritje vjetore prej 3.6 milionë dollarësh.

- Investime të tjera

Llogaria “investime të tjera” përfshin të gjitha transaksionet financiare të cilat nuk konsiderohen investime direkte, investime portofoli apo mjete të rezervës. Në Shqipëri, kjo kategori përfshin kryesisht huamarrjen, monedha dhe depozita si dhe borxhin mes kompanive. Një faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare janë lëvrimet e kredive afatgjata dhe të atyre të buta nga jashtë, të cilat e kanë shtuar borxhin e jashtëm të Shqipërisë me 230 milionë usd. Në këtë borxh, përfshihet edhe përdorimi i huave dhe kredive në Fond, prej 12 milionë usd. Në masë të konsiderueshme (34 për qind) huamarrja është përdorur nga sektori privat dhe vlerësohet rreth 6 herë më e lartë, në krahasim me vitin 2003. Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit dhe të interesit, gjatë periudhës arritën në rreth 70 milionë usd dhe vlerësohen në rreth 4.3 për qind të eksportit (mallra dhe shërbime). Detyrimet financiare në formën e depozitave të jorezidentëve në sistemin tonë bankar janë rritur me rreth 3.4 milionë usd. Në përbërjen e tyre sipas monedhës peshën më të madhe e zë monedha evropiane euro, konkretisht 78 për qind. Detyrimet në formën e kredisë tregtare u rritën me 23 milionë dollarë, e reflektuar kjo edhe në rritje të importeve për këtë periudhë. Pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur në 159 milionë dollarë ose rreth 27 për qind më shumë se në një vit më parë. Peshën më të madhe në këtë rritje e mban rritja e mjeteve valutore në formën e depozitave të njësive rezidente jashtë. Ky fluks i madh depozitash nga brenda-jashtë, ka ardhur kryesisht nga konvertimi i kapitalit të bankës “Raiffeisen” si dhe nga një zhvendosje në formën e investimit – nga investime portofoli në depozita.

Mjetet valutore, të zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë, janë rritur me rreth 90 milionë dollarë. Në përbërjen e depozitave të zotëruara nga sistemi bankar, 58 për qind e tyre janë në dollarë, ndërsa pjesa tjetër është në euro (39 për qind) dhe stërlina angleze (3 për qind). Përsa i përket mjeteve valutore cash, tremujori i fundit i vitit regjistroi një rritje të konsiderueshme të tyre (22.4 milionë usd), ndërkohë që gjatë periudhave

të mëparshme këto nuk kanë shfaqur luhajtje domethënëse. Në përbërjen e tyre në fund të vitit 2004, mjetet valutore cash në dollarë amerikanë zinin 26 për qind dhe ato në euro 70 për qind, stërlina angleze 3 për qind dhe franga zviceriane 1 për qind.

Grafik 1.6. Rezerva valutore në muaj importe.



III.3. REZERVAT VALUTORE

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 350 milionë dollarë. Rezerva valutore në fund të vitit 2004 shënoi nivelin 1.374 miliardë dollarë, duke qenë e mjaftueshme për të mbuluar rreth 5.1 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

IV. BORXHI I JASHTËM

Huamarrja e jashme i jep mundësinë një ekonomie të investojë dhe të konsumojë përtej kufijve të prodhimit të brendshëm, duke krijuar strukturën e kapitalit jo vetëm me aktivizimin e kursimeve të brendshme, por gjithashtu, duke shfrytëzuar kursimet e vendeve me suficit kapitali.


Në fund të vitit 2004, borxhi i jashtëm¹³ i Shqipërisë u rrit me rreth 220 milionë dollarë ose me 15 për qind krahasuar me fundin e vitit 2003, duke arritur në nivelin 1.674 miliardë dollarë. Aktualisht, borxhi i jashtëm vlerësohet të ketë arritur nivelin 22 për qind të PBB-së duke qenë rreth 3 pikë përqindjeje më i ulët se borxhi në vitin 2003. Sipas të dhënave statistikore, huamarrja qeveritare zë peshën kryesore në pozicionin e borxhit të jashtëm. Borxhi i jashtëm i Qeverisë Shqiptare, në fund të vitit 2004, është vlerësuar 1.299 miliardë dollarë duke përfaqësuar rreth 78 për qind të borxhit të jashtëm në total. Shqipëria vazhdon të riskedulojë detyrimet e prapambetura. Borxhi i riskeduluar vlerësohet në nivelin 84 milionë dollarë me një rritje vjetore prej 9 milionë dollarësh. Borxhi i ri i Qeverisë Shqiptare është rritur me 155 milionë dollarë dhe kapi shifrën 1.214 miliardë dollarë.

Borxhi i jashtëm zyrtar, i shpërndarë sipas sektorëve të ekonomisë kryesohet nga sektori energjitik me 29 për qind, ndjekur nga sektori i transportit me 22 për qind, mbështetje për buxhetin 19 për qind, infrastrukturë urbane dhe rurale dhe ujësjellësa e kanalizime me nga 8 për qind ndaj totalit.

Kreditori kryesor multilateral gjatë dhjetë viteve të fundit mbetet IDA, duke mbuluar rreth 82 për qind të totalit të kredive shumëpalëshe. Ndërsa përsa i përket kredive dypalëshe, partnerët kryesorë të huamarrjes qeveritare janë Italia dhe Gjermania me përkatësisht 40 dhe 25 për qind ndaj totalit. Kreditorët kryesorë të borxhit të riskeduluar janë Rusia dhe Kina.

Viti 2004 regjistroi rritje të ndjeshme përsa i përket borxhit të sektorit privat. Me një rritje vjetore prej 43 milionë dollarësh, borxhi i sektorit privat e ka rritur nivelin e përfaqësimit në totalin e borxhit me 3 pikë përqindje dhe ka kontribuar në masën 20 për qind në rritjen totale të borxhit të jashtëm kundrejt një viti më parë. Gjithashtu, me rritjen e huamarrjes nga jashtë është rritur niveli i përfaqësimit të sistemit bankar në totalin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë. Kjo rritje ka financuar kryesisht konsumin e ekonomisë, e reflektuar edhe në rritje të importeve për konsum, si dhe ka financuar nevojat për kapital


Grafik 17. Struktura e borxhit të jashtëm sipas sektorëve debitorë.



dhe/ose mallra kapitalë të kompanive. Borxhi i Autoritetit Monetar vlerësohet rreth 120 milionë dollarë, nga të cilat 96 milionë dollarë kanë qenë përdorim i kredive të fondit (FMN). Në sektorët e tjerë¹⁴ stoku i borxhit është 54 milionë dollarë dhe është rritur 23 për qind në krahasim me vitin 2003.

Përsa i përket borxhit të qeverisë, që përfaqëson në masë të konsiderueshme borxhin e jashtëm të Shqipërisë me botën, të dhënat tregojnë se transaksionet neto kanë kontribuar në masën 107 milionë dollarë ose 69 për qind të rritjes prej 154 milionë dollarësh, ndërkohë që pjesa tjetër (rreth 30 për qind) është rezultat i lëvizjeve të kursit të këmbimit. Struktura e borxhit të jashtëm sipas monedhave mbizotërohet nga Sdr (rreth 56 për qind) e ndjekur nga monedha evropiane (12 për qind), dollari amerikan (11 për qind) dhe monedha të tjera.

Grafik 18. Struktura e borxhit të jashtëm sipas monedhave.



Përmirësimi i kapaciteteve në eksporte rrit besueshmërinë për aftësi administruese të borxhit të jashtëm. Gjithashtu, një zhvillim pozitiv për vendin, gjatë vitit 2004, ishte nënshkrimi në muajin korrik i Memorandumit të Katërt me Fondin Monetar Ndërkombëtar për Mbështetje në Reduktimin e Varfërisë dhe Rritjen Ekonomike (PRGF).

ANEKS


1. TREGTIA ME VENDET E RAJONIT NË KUADËR TË MARRËVESHJEVE TË TREGTISË SË LIRË.


Me nënshkrimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë me Bosnje-Hercegovinën (8 prill 2003) dhe hyrjen në fuqi të saj (1 dhjetor 2004), Shqipëria e konsideron të përmbushur detyrimin për krijimin e rrjetit të tregtisë së lirë brenda kuadrit të integritimit ekonomik rajonal.

Efektet e pritshme të liberalizimit tregtar midis vendeve të rajonit konsiderohen shumëpërmasore. Zgjerimi i tregut mund të gjenerojë përparësi të shumta: Së pari, kompanitë detyrohen të ndryshojnë "sjelljen" në treg. Të mësuara të operojnë në një situatë monopol, tashmë atyre do t'u duhet të përballohen me konkurrencën e kompanive të tjera në treg. Për "të mbijetuar" do t'u duhet të operojnë me eficiencë dhe me kosto më të ulët, duke sjellë më të rëndësishmen për konsumatorin, çmime të ulta. Së dyti, zgjerimi i tregut lejon shfrytëzimin më mirë të ekonomive të shkallës, që do të thotë, përsëri prodhim me çmime më të ulta dhe në sasi më të mëdha. Për më tepër, një ambient konkurrent prodhimi jo vetëm rrit efekshmërinë e procesit të prodhimit dhe të administrimit por gjithashtu, rrit produktivitetin e tregut të punës.

Megjithëse ka rreth 2 vjet e gjysmë nga aplikimi i marrëveshjes së parë të tregtisë së lirë në rajon, përfitimet tregtare për Shqipërinë konsiderohen ende të kufizuara. Shtetet partnere duket të jenë treguar më agresive për të shfrytëzuar mundësitë për tregti në kushte lehtësuese. Edhe pse, gjatë vitit 2004, tregtia me vendet e rajonit, me të cilat kemi të nënshkruar MTL, ka njohur zhvillime pozitive (grafik 1), ajo mbetet e kufizuar në vetëm me dy vende (Kosovë dhe Maqedoni). Ndërkohë që, efektet e MTL-ve me vendet e tjera mbeten ende të pandjeshme. Vëllimi i eksporteve shqiptare në rajon, për vitin 2004, arriti në 7 për qind nga 3 për qind në vitin 2003.

Nga ana e importeve, shkëmbimet me Maqedoninë, me Bullgarinë dhe me Kroacinë





zënë peshën kryesore të tregtisë, duke shfaqur gjithashtu dhe normat më të larta në rritje. Importet vlerësohen në rreth 130 milionë usd dhe mbeten afër të njëjtit nivel përfaqësimi, ndaj totalit të importeve, të një viti më parë.

Deficiti tregtar i Shqipërisë në rajon, gjatë vitit 2004, vlerësohet në rënie (rreth 6 për qind).

Sikurse përmendim më sipër marrëveshje të tilla, përveç mundësive për fitim, mbartin edhe rrezikun e ekspozimit ndaj konkurrencës në tregje, për të cilën vendi mund të mos jetë plotësisht ose mjaftueshmërisht i përgatitur. Për këtë arsye, politikat dhe programet e mbështetjes së prodhimit vendas dhe sidomos të sektorëve që kontribuojnë për eksporte, marrin një rëndësi të veçantë. Krijimi i kushteve për kontrollin e prodhimeve, për ngritjen e cilësisë së tyre, për uljen e kostove të prodhimit, të etiketimit apo të transportit, për aplikimin e standardeve bashkëkohore në të gjitha drejtimet e vlerësimit të prodhimeve, është domosdoshmëri për ta vendosur Shqipërinë në baza të përafërta konkurrence me shtetet partnere në rajon. Gjithashtu, përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës, është një tjetër faktor i rëndësishëm për përshejtimin e tregtisë në rajon.

Në vijim po japim një paraqitje të përmbledhur të zhvillimeve tregtare, gjatë vitit 2004, me secilin vend partner në marrëveshje të lirë tregtare.

TREGTIA ME MAQEDONINË.

Për Shqipërinë MTL me Maqedoninë është e para e aplikuar (15 korrik 2002) në setin e MTL-ve në rajon. Vërehet se gjatë vitit 2004, MTL ka rezultuar frytdhënëse për të dyja vendet, ndërkohë, që gjatë vitit paraardhës u regjistrua rënie vjetore e vëllimit tregtar mes dy vendeve. Maqedonia përfaqëson partnerin e dytë tregtar të Shqipërisë në rajon, duke zënë rreth 19 për qind të vëllimit të shkëmbimeve tregtare gjatë vitit 2004. Gjatë këtij viti, ecuria në importe dhe eksporte ka qenë pozitive. Vlen të theksohet se eksportet shqiptare kanë shfaqur normë vjetore rritjeje më të lartë (rreth 144 për qind) se importet (51 për qind) me këtë vend. Shkëmbimet tregtare me Maqedoninë karakterizohen nga një gamë e gjerë produktesh, duke shënuar, gjithashtu, rritje të numrit të agjentëve tregtarë në eksporte. Vlen për t'u theksuar fakti që pjesa më e madhe e prodhimeve industriale si të importuara ashtu edhe të eksportuara nga vendi ynë, janë plotësisht të liberalizuara. Disa nga prodhimet që kanë konsoliduar pozicionin e tyre në tregun maqedonas janë mobilje druri, karburante, çimento etj.. Ndërkohë, përsa i përket realizimit të kuotave për prodhimet bujqësore, pozitivisht paraqitet ecuria për linja produktesh të importuara dhe i ngadaltë realizimi i kuotave në eksporte.

Deficiti tregtar me Maqedoninë, ndaj një viti më parë, ka ardhur duke u thelluar (rreth 29 për qind).

TREGTIA ME KROACINË.

Kroacia në vite është renditur si burimi i dytë kryesor i importeve tona në rajon, si dhe është karakterizuar nga një deficit i ndjeshëm tregtar. Marrëveshja e tregtisë së lirë me këtë vend funksionon që prej 1 qershorit 2003, megjithatë gjatë vitit 2004 kemi pasur rritje të vogël nga të dyja krahët. Produktet më të importuara kanë qenë energjia dhe gruri. Përsa i përket përbushjes së kuotave në eksporte, nga një listë prej 14 produktesh, Shqipëria ka eksportuar vetëm 1, ndërsa Kroacia 3 nga 19 linja produktesh.

TREGTIA ME BULLGARINË.

Bullgaria përfaqëson partnerin kryesor të Shqipërisë në rajon, duke zënë rreth 28 për qind të vëllimit tregtar rajonal të vendit. Tregtia me këtë shtet është e përqëndruar në kahun e importeve, të cilat përfaqësojnë 35 për qind të totalit të importeve nga rajoni. Ndërkohë, eksportet me destinacion Bullgarinë karakterizohen nga vëllime tepër të ulta. Megjithatë, shenja përmirësimi të eksporteve tona me këtë vend janë vërejtur pas hyrjes në fuqi të MTL-së (1 shtator 2003) – eksportet janë rritur me rreth 8 herë. Vëmë re që gati për të gjitha prodhimet me origjinë shqiptare është negociuar të zbatohet tarifa doganore zero, dhe lista e këtyre produkteve është pasuruar gjatë vitit 2004. Shqipëria nuk ka arritur të realizojë gjatë vitit asnjë nga kuotat e akorduara për eksporte, ndërsa Bullgaria në të kundërt ka përdorur pjesën më të madhe të tyre. Një tjetër karakteristikë e tregtisë me këtë vend është shumëllojshmëria e produkteve të eksportuara në tregun shqiptar.

TREGTIA ME KOSOVËN.

MTL me Kosovën, që funksionon që prej tetorit të vitit 2003, vërehet të ketë dhënë efektet e saj të ndjeshme gjatë vitit 2004, duke shënuar kështu një kthesë pozitive në shkëmbimet tregtare ndërmjet dy vendeve. Vëllimi i përgjithshëm tregtar me Kosovën (prej rreth 31 milionë usd) arriti në rreth 18 për qind të shkëmbimeve tregtare të Shqipërisë në rajon, nga 8 për qind në vitin 2003. Impaktin më të madh në këtë rritje e kanë pasur eksportet, të cilat u rritën më shumë se 3 herë. Kosova është partneri i vetëm tregtar me të cilin Shqipëria ka bilanc tregtar pozitiv. Në strukturën e eksporteve sipas mallrave, përmendim produktet bujqësore si pijet dhe alkolet, vezët, duhanin etj., si dhe produkte industriale ndër të cilat metalet bazë, mobilje druri detergjentë etj.. Përgjithësisht ato përfshihen në listën e produkteve të liberalizuara. Ndërsa tregu shqiptar ka shfaqur interes për mjete transporti, tuba gize, patate, lëngje frutash etj., që në kuadër të MTL-së janë pa tarifa doganore. Birra është i vetmi produkt shqiptar i eksportuar duke shfrytëzuar kuotat e dhëna.

TREGTIA ME RUMANINË.

Rumania është i vetmi vend i rajonit me të cilin janë zvogëluar shkëmbimet tregtare krahasuar me një vit më parë edhe pse viti 2004 shënon fillimin e tregtisë së lirë ndërmjet dy vendeve (aplikuar nga 1 janari i vitit 2004). Impaktin më të madh e ka sjellë ulja e importeve (33 për qind), ndërsa eksportet vlerësohen në nivele minimale (rreth 227 mijë usd). Niveli i përfaqësimit të Rumanisë në shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me rajonin ra në 6 për qind nga 12 për qind në vitin e kaluar. Pjesa dërrmuese e importeve kanë qenë produkte industriale të përfshira në regjimin doganor pa tarifë. Shqipëria nuk

ka mundur të realizojë kuotat e akordura nga Rumania, ndërsa kjo e fundit ka eksportuar vetëm 2 linja produkti nga 17.

TREGTIA ME SERBINË DHE MALIN E ZI.

Deficiti tregtar me këto vende ka ardhur duke u thelluar gjatë këtij viti, si rezultat i rritjes së importeve (me 58 për qind) dhe zvogëlimit të eksporteve (20 për qind). Rreth 66 për qind e importeve janë realizuar mbas hyrjes në fuqi të marrëveshjes (më 1 gusht 2004) dhe ndër këto përmendim dy produkte që patën luhatjen më të madhe dhe që shprehin më qartë efektin e saj, mielli dhe sheqeri, të cilat trajtohen me kuota. Ndërkohë që, produktet më të eksportuara paraqiten krejtësisht të liberalizuara shkëmbimet në eksporte janë të dobëta: nuk është mundur të përfitohet nga asnjë koncension që Serbia dhe Mal i Zi na ka akorduar.

TREGTIA ME BOSNJE-HERCEGOVINËN DHE MOLDAVINË.

Tregtia me këto dy vende është pothuajse e pazhvilluar, megjithëse gjatë këtij viti, ndonëse në nivele mjaft modeste, ka shenja të fillimit të shkëmbimeve. Ndërsa importet me Bosnjen janë ulur, ato me Moldavinë kanë pësuar një rritje të konsiderueshme duke kapur një vlerë të përafërt me atë të Kosovës. Nivelet e eksporteve kanë pasur luhatje gjatë këtij viti por përsëri ato mbeten pothuajse inekzistente. Nuk mund të flasim për efekte të MTL pasi ato kanë hyrë në fuqi në fund të vitit 2004. Shkalla e liberalizimit të sektorit të bujqësisë rezulton shumë e ulët krahasuar me atë të Maqedonisë, ndërsa sektori i industrisë pritet të liberalizohet plotësisht.

2. ANALIZA E REZULTATEVE TË VROJTIMIT TË TURIZMIT PËR VITIN 2004

2.1. METODOLOGJIA E VROJTIMIT

Metodologjia është paraqitur sipas hapave në të cilët është kryer çdo fazë e vrojtimit që nga viti 1999.

Vrojtuesi-Banka e Shqipërisë.

Intervistuesi-Intervistuesi në terren, nën drejtimin e INSTAT.

Anketim-Intervistimi në terren.

a - Qëllimi i vrojtimit - Qëllimi i këtij vrojtimi është mbledhja e informacionit mbi ditëqëndrimin mesatar dhe shpenzimet mesatare ditore të turistëve rezidentë dhe jorezidentë, gjatë udhëtimeve të tyre përkatësisht jashtë dhe brenda Shqipërisë.

b - Përcaktimi i popullatës dhe i pikave të intervistimit - Popullata që synohet të mbulohet nëpërmjet këtij vrojtimi përbëhet nga dy grupe. Njëri është grupi i turistëve rezidentë (me kombësi shqiptare ose jo) që kthehen nga udhëtimi jashtë shtetit për qëllime turizmi; dhe tjetri është grupi i turistëve jorezidentë (me kombësi shqiptare ose jo), që largohen nga Shqipëria pas një udhëtimi turistik.

Pikat në të cilat kryhet intervistimi janë kufijtë doganorë të Republikës së Shqipërisë. Duke shfrytëzuar të dhënat e Ministrisë së Rendit Publik mbi numrin e hyrje-daljeve në territorin e Republikës së Shqipërisë (të dhënat për vitin 2003), si dhe duke siguruar një përfaqësim në rreth 80 për qind të këtij fluksi, përcaktohen pikat për intervistim.

c - Zgjedhja e mostrës për intervistim - Zgjedhja e popullatës për vrojtim përcaktohet nisur nga regjistrimet e Ministrisë së Rendit Publik mbi fluksin e hyrje-daljeve në kufijtë e Republikës së Shqipërisë, për vitin 2003. Për përcaktimin e vëllimit të zgjedhjes (mostrës) për çdo pikë kufitare kemi përdorur metodën e zgjedhjes tipike proporcionale, si mënyra më e përshtatshme për rastin tonë me të dhëna të grupuara.

d - Përpunimi i të dhënave - Hedhja dhe përpunimi i të dhënave realizohen pranë Bankës së Shqipërisë nga operatorë dhe nga specialistë të Zyrës së Bilancit të Pagesave. Para se të fillojë përpunimi, bëhet pastrimi i të dhënave nga vlerat ekstreme si edhe konvertimi në dollarë i shumave të raportuara në monedha të ndryshme, si dhe konvertimi i muajve në ditë. Shpeshherë, përpunimi i të dhënave kombinohet me verifikimin e pyetësorëve të plotësuar për të përcaktuar më mirë llojin e turistit dhe veçoritë e tij.

PROBLEMATIKA

1. Statistikat mbi hyrje-daljet e turistëve sigurohen nga Ministria e Rendit Publik katër herë në vit. Kriteri mbi të cilin ndërtohen këto statistika, është ai i kombësisë dhe jo ai i rezidencës, që do të ishte në përputhje me kërkesat e bilancit të pagesave. Në pamundësi për të ndryshuar kriterin e regjistrimit të udhëtarëve nëpër porte, është pranuar si popullatë ajo e siguruar nga Ministria e Rendit Publik. Në këto kushte, këto statistika modifikohen për t'u përafuar me popullatën e kërkuar nga vrojtimi. Modifikimi nënkupton kryesisht korrigjimin e numrit të shqiptarëve që hyjnë në Shqipëri, nën supozimin që një pjesë e tyre janë rezidentë jashtë dhe nuk mund të klasifikohen si turistë rezidentë që kthehen nga udhëtimi. Për arsyen e lartpërmendur, në analizën e mëposhtme termat e përdorur do të jenë "turistë shqiptarë" dhe "turistë të huaj" në vend të turistëve "rezidentë" dhe "jorezidentë".

2. Pavarësisht nga trainimi i intervistuesve, plotësimi i pyetësorëve ka paraqitur jo rrallë probleme të konceptimit nga ana e intervistuesve. Për shembull, edhe pse intervistuesve iu kërkohet (edhe nga pyetësi) të bëjnë seleksionimin e turistëve sipas vendit të rezidencës, pra Shqipëri ose vend tjetër, ata vazhdojnë të drejtohen tek turistët e huaj për të plotësuar pyetësorët për jorezidentët dhe tek turistët me kombësi shqiptare (duke përfshirë edhe emigrantët shqiptarë) për pyetësorët e destinuar për rezidentët. Cilësia e përgjigjeve për pyetjet sasiore është vështirë të kontrollohet, për shkak të pamundësisë për të siguruar këtë informacion apo çfarëdolloj informacioni të ngjashëm me këtë, nga burime të tjera. Për shembull, nëse një pyetësor tregon se një turist jorezident ka shpenzuar 10,000 usd gjatë një qëndrimi njëjavor në Shqipëri, për vrojtuesin është e pamundur të verifikojë vërtetësinë e pohimit apo të përcaktojë nëse problemi rrjedh nga intervistuesi, që mund ta ketë plotësuar vetë pyetësorin apo nga vetë i intervistuari, që fare mirë mund të

mos thotë të vërtetën. Megjithatë, për të minimizuar gabimet, vrojtuesit, gjatë përpunimit të rezultateve, bëjnë pastrimin e të dhënave nga shifrat që duket se janë larg pjesës më të madhe të përgjigjeve, pra nga vlerat ekstreme.

2.2. REZULTATET E VROJTIMIT PËR VITIN 2004.


Megjithëse numri i udhëtarëve të huaj që vizitojnë Shqipërinë është i vogël krahasuar me destinacionet kryesore të Evropës, vitet e fundit janë karakterizuar nga një ecuri pozitive në terma të rritjes së numrit të vizitorëve të huaj. Sipas statistikave të Ministrisë së Rendit Publik, numri i shtetasve të huaj në hyrje është rritur me një ritëm mesatar vjetor prej 20 për qind, nga viti 2000 në 2004. Fluksi hyrës i shtetasve të huaj, përgjatë vitit 2004, u rrit me 16 për qind kundrejt vitit të kaluar. Udhëtarët të cilët kanë prekur tranzit territorin shqiptar për vitin 2004, vlerësohen në 12 për qind të totalit. Për vitin 2003 numëroheshin rreth 112 mijë udhëtarë tranzit ose 20 për qind e totalit të hyrjes së shtetasve të huaj. Fluksi i shtetasve shqiptarë të cilët udhëtojnë jashtë vendit, ka ardhur gjithashtu në rritje. Rritja vjetore për vitin 2004 vlerësohet 25 për qind, ndërsa rritja e mesatare për periudhën 2000-2004 vlerësohet 12 për qind.

Për mbledhjen e informacionit sasior dhe cilësor janë vrojtuar shtetasit shqiptarë dhe të huaj në kufijtë doganorë të Republikës së Shqipërisë. Të dhënat sasiore mbi vlerësimin e shpenzimeve mesatare ditore si dhe vlerësimin e ditëqëndrimit mesatar për turistë të huaj dhe shqiptarë (këto për qëllime udhëtimi biznesi dhe personale), kanë lidhje direkte me përpilimin e bilancit të pagesave.

Përsa i përket kombësisë së turistëve të huaj (ku termi “i huaj” reflekton rezidencën), në këtë grup bëjnë pjesë një numër i konsiderueshëm vizitorësh shqiptarë me banim jashtë. Prania e tyre varion përgjatë tremujorëve, duke përfaqësuar në një interval 40-55 për qind totalin në sezone pushimesh

dhe në intervalin 25-35 për qind në periudhat e tjera të vitit. Ka mëse dy vjet që Shqipëria predominohet nga një fluks i vizitorëve kosovarë. Më parë pjesa më e madhe e vizitorëve të huaj vinin nga vendet fqinje, kryesisht nga Italia dhe Greqia. Konflikti në Kosovë (1999) dhe ardhja e mijëra kosovarëve në Shqipëri, e ekspozoi këtë të fundit në sytë e kosovarëve. Pas kthimit të kosovarëve në tokën e tyre dhe rifillimit të një jete normale, proces që zgjati për rreth dy vjet, Shqipëria filloi të shihte flukse të pazakonta të hyrjeve të kosovarëve, sidomos në periudhat e pushimeve. Kjo u shoqërua gjithashtu, edhe me fluksin e shqiptarëve të Maqedonisë si pasojë e konflikteve në vend. Shpenzimet në valutë të udhëtarëve shqiptarë jashtë vendit kanë shkuar kryesisht për vendet fqinje si Italia, Greqia dhe

Grafik 1. Hyrjet e shtetasve të huaj dhe emigrantëve sipas shteteve.




Kosova. Konkretisht për arsye biznesi 20 për qind e udhëtarëve shkojnë në Kosovë, 20 për qind në Itali dhe 50 për qind në Greqi. Kurse për arsye personale (pushime) 10 për qind në Kosovë, 40 për qind në Greqi dhe 35 për qind në Itali.


ARSYET E UDHËTIMIT

Arsyet e udhëtimit të vizitorëve të huaj në Shqipëri kushtëzohen nga periudhat e vitit. Periudha e verës karakterizohet nga turistë që udhëtojnë për pushime, ndërkohë që pjesa tjetër e vitit karakterizohet nga turistë që lëvizin për qëllime biznesi dhe për qëllime të tjera. Kështu, mesatarisht 80 për qind e vizitorëve udhëtojnë në Shqipëri për qëllime personale dhe 20 për qind për qëllime biznesi. Analizë e njëjtë mund të bëhet dhe për turistët shqiptarë që udhëtojnë jashtë kufijve të Shqipërisë. Kështu mesatarisht 30-40 për qind udhëtojnë për qëllime biznesi dhe 60 për qind për qëllime të tjera.


Grafiku i mëposhtëm paraqet ditëqëndrimin mesatar për turistët e huaj dhe shqiptarë, sipas qëllimit të udhëtimit për periudhën 2002-2004. Vërehet se ditëqëndrimi i turistëve shqiptarë jashtë ka ardhur duke u ulur për ata që udhëtojnë për qëllime biznesi dhe duke u rritur për ata që udhëtojnë për qëllime personale. Për turistët e huaj, qëndrimi në të dyja rastet luhet tek 10 ditë.



Nga analiza e rezultateve të vrojtimit, përsa i përket shpenzimeve mesatare ditore gjatë vitit 2004, shpenzimet e udhëtarëve të huaj për qëllime biznesi në Shqipëri kanë ardhur në rritje, ndërkohë që kategoria biznes e udhëtarëve shqiptarë jashtë, ka shfaqur shpenzime relativisht më të ulëta krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë që, shpenzimet mesatare vjetore për qëllime personale kanë ardhur lehtësisht në rritje, si për udhëtarët e huaj ashtu edhe për ata shqiptarë.



Për të analizuar aspekte cilësore të sjelljes së turistëve të huaj në vend dhe anasjelltas konsiderohen aspekte të tjera të vërtetimit, si diversifikimi i shpenzimeve në akomodim, ushqim dhe shpenzime të tjera; vendi i rezidencës së turistëve të huaj etj..



Vihet re që kategoria “shpenzime të tjera” ka peshë të konsiderueshme për të dyja grupimet e turistëve. Gjithashtu, nisur nga fakti që emigrantët përgjithësisht shfaqin sjelljen e turizmit familiar, shpenzimet për akomodim dhe ushqim të kësaj kategorie zënë një peshë më të vogël në totalin e shpenzimeve krahasimisht me turistët e huaj. Ndërkohë, përsa i përket shpërndarjes strukturore të shpenzimeve të bëra nga udhëtarët shqiptarë jashtë, sjellja është e ngjashme me atë të emigrantëve. Kështu, nga rezultatet e vërtetimit, mesatarisht për vitin 2004 rreth 17 për qind e shpenzimeve jashtë ka shkuar për akomodim, rreth 16 për qind për ushqim dhe 67 për qind për të tjera (pazare etj.).

ANEKS - FJALOR

Rezident- individë ose kompani që e kanë qendrën e interesit ekonomik brenda territorit ekonomik të shtetit, i cili harton statistikën (në rastin tonë, të Shqipërisë). Në lidhje me kategorinë e shërbimeve të turizmit, në të cilën aktorët janë individët që udhëtojnë, qendra e interesit ekonomik është shteti, në të cilin individët konsumojnë mallra dhe shërbime si edhe marrin pjesë në procesin e prodhimit të këtyre të mirave.

Udhëtarë - Sipas FMN-së, janë individët që qëndrojnë jashtë vendit për më pak se një vit për çdo qëllim tjetër përveçse: (a) për të punuar në një bazë ushtarake, ambasadë e të tjera agjenci qeveritare, ose (b) për të shoqëruar ose për të qenë nën varësinë direkte të individëve të kategorisë (a) apo (c) për t'u angazhuar direkt në aktivitet prodhues për një njësi rezidente të ekonomisë në fjalë.

Turistë – Udhëtarë, të cilët kalojnë të paktën një natë në vendin që vizitojnë.

“Turizëm” në gjuhën e bilancit të pagesave – Përbërës i bilancit të pagesave në të cilin regjistrohen transaksionet në mallra dhe shërbime të lidhura me shpenzimet e turistëve. Sipas manualit të FMN-së, këto transaksione regjistrohen në debinë dhe kredinë e zërit “udhëtime”.

Shpenzimet e turistëve - Shpenzimet totale në mallra dhe shërbime të bëra nga një udhëtar ose për llogari të një udhëtari, për dhe gjatë udhëtimit dhe qëndrimit në destinacion.

Udhëtim personal – Shpenzime të bëra nga individë që shkojnë jashtë për qëllime të ndryshme nga biznesi. Këtu përfshihen pushimet dhe aktivitete të tjera argëtuese dhe kulturore, vizita tek miqtë dhe të afërmit, udhëtime për qëllime pelegrinazhi dhe arsye të tjera fetare, edukim, trajtim shëndetësor etj..

Udhëtim biznesi – Përfshin shpenzime të bëra nga: a) individë që shkojnë në një vend të ndryshëm nga ai ku punojnë zakonisht, me qëllim që të ndërmarrin çfarëdolloj aktiviteti profesional: shitje, takime pune etj.. b) punëtorë sezonalë dhe kufitarë.

REFERENCA

¹ Për më tepër rreth trajtimit të deficiteve korente për ekonomitë në tranzicion referojuni 'Current Account Balance and External Debt in Transition Economies', Paul Wachtel and Nouriel Roubini, National Bureau of Economic Research.

² Llogaritur si diferencë e të ardhurave (përfshirë grantet) me shpenzimet korente.

³ E matur me raportin e eksportit dhe importit të mallrave dhe shërbimeve ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto.

⁴ Përfshin borxhin publik dhe privat.

⁵ E llogaritur si raport i vëllimit tregtar në mallra dhe shërbime ndaj PBB-së.

⁶ Sipas vlerësimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, rreth 57 për qind e transaksioneve për importe mallrash kryhen në monedhën evropiane euro, 39 për qind në dollarë amerikanë dhe rreth 4 për qind në monedha të tjera.

⁷ Kursi real i këmbimit u vlerësua me 7.3 për qind gjatë vitit 2004, duke shënuar një kthim të kahut zhvlerësues gjatë vitit 2003.

⁸ Mallra të përpunuar për eksport nga bizneset e huaja që zhvillojnë aktivitet në vend.

⁹ Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë në totalin e hyrjeve rreth 84 për qind janë të ardhura në euro (duke përfshirë këtu shtetas të ardhur nga vendet e Bashkimit Evropian si dhe nga Kosova dhe Mali i Zi).

¹⁰ Në vitin 2004, u krijua Kodi Detar për Shqipërinë, i cili sanksionon krijimin dhe funksionimin e institucioneve bazë që rregullojnë veprimtarinë në këtë sektor, sipas kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare.

¹¹ Përveç kompanisë INSIG, dy kompanitë e reja të licencuara në vitin 2004, SICRED dhe SIGAL LIFE do t'i ofrojnë tregut shqiptar të sigurimeve, sigurimin e jetës.

¹² Aktualisht në Shqipëri nuk ka mjete financiare në formën e investimeve të portofolit, të cilat të mund të blihen nga jorezidentët. Bonot e thesarit të emetuara nga qeveria janë, të cilat ofrohen në monedhën vendase, nuk blihen nga jorezidentët.

¹³ Në këtë statistikë nuk përfshihen detyrimet e lindura nga investimet e huaja direkte.

¹⁴ Këtu përfshihen kompani si Albtelekomi apo KESH, për borxhin e të cilave bëhet garant Qeveria Shqiptare.